



TË DIPLOMUARIT NGA ARSIMI PROFESIONAL 2020-2021 GJURMIMI NË NIVEL KOMBËTAR

Një projekt i Agjencisë Zviceriane për
Zhvillim dhe Bashkëpunim SDC

 Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra


Agjencia Zvicerane për Zhvillim
dhe Bashkëpunim SDC

Në partneritet me:



Zbatuar nga:


swisscontact



TË DIPLOMUARIT NGA ARSIMI PROFESIONAL 2020-2021: GJURMIMI NË NIVEL KOMBËTAR

Tetor 2022



TË DIPLOMUARIT NGA ARSIMI PROFESIONAL 2020-2021: GJURMIMI NË NIVEL KOMBËTAR

Tetor 2022

Ky publikim është realizuar nga projekti “Aftësi për Punë” (S4J) nën mbikqyrjen e Menaxherit të Projektit, Fation Dragoshi. Raporti u përgatit nga Assoc. Prof. Juna Miluka, konsulente dhe Assoc. Prof. Ines Nurja, konsulente për metodologjinë.

Rreth projektit “Aftësi për Punë”

“Aftësi për Punë” (S4J) është një projekt i Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC), i cili zbatohet në Shqipëri nga organizata Swisscontact.

S4J adreson sfidat kryesore në Ansimin dhe Formimin Profesional (AFP) në Shqipëri duke investuar për sigurimin e ndryshimeve sistematike, zhvillimin e kompetencave dhe fuqizimin e aktorëve. S4J mbështet ofruesit partnerë të AFP-së në drejtim të krijimit të lidhjeve të ngushta me kompanitë e sektorit privat dhe partnerë të tjerë, diversifikimit dhe përmirësimit të ofertës mësimore, aplikimit të metodave të reja të mësimdhënies dhe standardeve të cilësisë, realizimit të praktikave mësimore në mjediset e biznesit dhe zhvillimit e fuqizimit të institucionit.

Shënim: Pikëpamjet dhe konkluzionet e shprehura në këtë publikim nuk paraqesin domosdoshmërisht ato të Qeverisë Zvicerane ose Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC).

TABELA E PËRMBAJTJES

PERMBLEDHJA EKZEKUTIVE

1. HYRJE	13
2. METODOLOGJIA	15
Qasja metodologjike	15
Instrumenti i studimit - pyetësoni	15
Analizimi i të dhënave	17
Kufizimet metodologjike	18
3. PËRSHKRIMI I DEMOGRAFISË	19
4. REZULTATET	21
4.1 Situata e punësimit e të diplomuarve	22
Situata aktuale e punësimit	22
4.2 Të diplomuarit e punësuar	27
Tranzicioni drejt tregut të punës – koha e gjetjes së punës së parë	27
Tranzicioni drejt tregut të punës – mënyra e gjetjes së punës së parë	30
Integrimi në tregun e punës – karakteristikat kryesore në punën aktuale	32
Integrimi në tregun e punës – të ardhurat	36
Integrimi në tregun e punës – përputhshmëria e arsimit	39
4.3 Të diplomuarit që po vazhdojnë kualifikime të mëtejshme	44
Institucioni arsimor në të cilin vazhdojnë studimet të diplomuarit	44
Lidhja mes fushës së studimeve me studimet e mëparshme	45
Arsyet kryesore të ndjekjes së studimeve/trajnimeve	46
4.4 Të diplomuarit pa punë	47
Të kërkuarit për punë	48
Marrëdhënia me zyrat e punës	50
Të diplomuarit e papunë në kërkim të një pune, që kanë qenë të punësuar më parë	53
4.5 Vlerësimi retrospektiv i të diplomuarve për shkollën	56
5. KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME	62



PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive (AKPA) me mbështetjen e projektit Aftësi për Punë (S4U) ndërmoni gjurmimin në nivel kombëtar të të diplomuarve të vitit shkollor 2020-2021 nga 34 shkollat publike të arsimit profesional në të gjithë Shqipërinë me qëllimin e përgjithshëm të monitorimit të treguesve kryesorë të tregut të punës për të diplomuarit nga sistemi i arsimit profesional të analizuar sipas 4 rajoneve: Rajoni Verior, Qendror, Juglindor dhe Jugperëndimor.

Studimet e gjurmimit ofrojnë një tablo të qartë të integritetit të të diplomuarve në tregun e punës dhe përfaqësojnë një burim të rëndësishëm për vlerësimin dhe mbështetjen në përmirësimin e cilësisë dhe përputhshmërisë së arsimit profesional me tregun e punës. Sondazhit të gjurmimit të zhvilluar gjatë muajve maj-qershor 2022, që përkon me periudhën 11-12 muaj pas diplomimit të tyre, iu përgjigjën 1283 të diplomuar që përfunduan studimet në vitin 2021. Disa nga gjetjet kryesore të sondazhit, janë përmbledhur më poshtë:

- Afërsisht 6 në 10 të diplomuar nga arsimi profesional në vitin 2022 ose 57.5% e totalit të të diplomuarve ishin në marrëdhënie pune 1 vit pas diplomimit, nga të cilët 38.3% ishin të punësuar me pagë, 8.0% ishin të vetëpunësuar, ndërsa 11.2% punonin dhe studionin në të njëjtën kohë.
- 34.8% rezultojnë të diplomuar jo aktivë, nga të cilët 23.5% ndiqnin kualifikime të mëtejshme si studentë apo kursantë, 10.8% ishin të papunë dhe nuk po kërkonin për punë, dhe 0.5% ishin duke përmbushur detyrat shtëpiake dhe në paaftësi të përhershme.
- 7.7% të diplomuar të papunë po kërkonin aktivisht për punë.
- Krahasimi i rezultateve me vitin 2021, tregon se kanë rritje të konsiderueshme të të diplomuarve të punësuar (nga 40.2% në 57.5%), shoqëruar me një rënie të të diplomuarve që vijojnë studime të mëtejshme (nga 28.5% në vitin 2020 në 23.5% në vitin 2021), çka tregon një tendencë më të lartë të brezit aktual për t'u integruar në tregun e punës.
- Ka dallime në shpërndarjen e statusit të punësimit sipas gjinisë. Të diplomuarit meshkuj, ishin më të prirur se të diplomuarat femra, për të qenë të punësuar me 59.8% e meshkujve të punësuar përkundrajt 46.1% të femrave.
- Të diplomuarit e Rajonit Qendror ishin më të prirur për të qenë të punësuar pas diplomimit, krahasuar me rajonet e tjera, nga ku më shumë se gjysma, 60.1% e të diplomuarve, ishin të punësuar, duke u ndjekur nga Rajoni Jugperëndimor me një diferencë shumë të vogël prej 0.8 pikë përqindje.
- Rajoni Juglindor dhe Jugperëndimor tregojnë përqindje më të larta të joaktivitetit (përkatesisht: 41.1% dhe 36%). Arsyeja kryesore e të qenit joaktivë për të katërta rajonet, lidhet me prinjen për të ndjekur kualifikimet e mëtejshme - rreth një e treta e të diplomuarve në të katërta rajonet.
- Të dhënat tregojnë se të diplomuarit në Hoteleri-Turizëm (70%), janë më të prirur për t'u punësuar, duke konfirmuar kështu, punësimin e formimeve profesionale të orientuara drejt kërkesave të tregut. Drejtimi hoteleri-turizëm pasohet nga drejtimet me karakter industrial, ku më shumë se gjysma e të diplomuarve të Elektroteknikës (55.4%) dhe SHMT (Shërbime mjetes transporti) (63.3%) ishin tashmë të punësuar pas mbarimit të arsimit profesional.

- Të diplomuarit meshkuj (91.3%) ishin më të prirur se të diplomuarat femra (86.5%) për t'u integruar në tregun e punës brenda 3 muajve pas mbarimit të shkollës. Gjithashtu, meshkujt ishin më të prirur të punonin në bizneset familjare (60.8%) ose të hapnin një biznes para diplomimit ose 1 muaj pas diplomimit krahasuar me femrat.
- Njohjet, lidhjet familjare dhe miqtë, përfaqësojnë mënyrën më të shpeshtë se si të diplomuarit e punësuar në të katërta rajonet kishin gjetur punën e tyre të parë. 81.5% e të diplomuarve, e kishin gjetur punën e tyre të parë nëpërmjet kësaj forme. Përdorimi i këtyre kanaleve joformale, ishte i përhapur pothuajse njësoj tek të katërta rajonet, ku mbi 80% e të diplomuarve, gjetën punën e tyre të parë nëpërmjet kontakteve familjare; ku më e theksuar vihet re tek Rajoni Jugperëndimor (84.6%).
- Për sa i përket gjetjes së punës së parë sipas drejtimeve profesionale që kanë mbaruar të diplomuarit, nuk ka asnjë ndryshim në mënyrën apo kanalet e përdorura. Të diplomuarit në të gjitha llojet e drejtimeve kanë gjetur punën e parë nëpërmjet njohjeve e kontakteve familjare (81.5%), dhe kanalet më pak të përdorura vijnë të jenë kanalet formale.
- Meshkujt janë të prirur më shumë se femrat të gjejnë punë nëpërmjet njohjeve dhe kontakteve familjare. Ndërsa femrat (16.8%) janë më të prirura se meshkujt (5.4%) të gjejnë punë nëpërmjet lajmërimeve të publikuara.
- Pjesa dërrmuese e të diplomuarve që ishin në marrëdhënie pune, punonin në ndërmarrje të vogla, duke reflektuar kështu edhe realitetin/natyrën e bizneseve në Shqipëri.
- Pothuajse gjysma e të diplomuarve në marrëdhënie pune (47%), kishin një perceptim neutral të sigurisë/stabilitetit në punën e tyre aktuale. Ky perceptim ishte më i theksuar në Rajonin Jugperëndimor (54,9%).
- Nëse u referohemi drejtimeve profesionale, rezulton se të diplomuarit në drejtimet teknike industriale si Elektroteknikë dhe SHMT, ishin më të prirur për t'u ndier të sigurt dhe të stabilizuar në vendin e tyre të punës, përkundrejt drejtimeve të tjera.
- 33.6% e të diplomuarve të punësuar, kishin të ardhura nga puna në nivelin 40.001-50.000 lekë, ku më i theksuar shfaqet në Rajonin Qendror (34.8%) dhe atë Jugperëndimor (34.2%).
- Tregohen dallime në paga bazuar tek gjinia, ku të punësuarat femra, paguhen më pak se të punësuarit meshkuj.
- Të diplomuarit në drejtimet Hoteleri-Turizëm dhe Elektroteknikë, rezultonin të punësuar me paga më të larta. Kështu, 35.1% e të diplomuarve në Hoteleri-Turizëm dhe 34.3% e të diplomuarve në Elektroteknikë, siguronin të ardhura më shumë se 50.001 lekë.
- Gjysma e të diplomuarve të punësuar ose 50.5%, punonin në një punë që lidhej me fushën/profilin që kishin studiuar.
- Ndarja sipas rajoneve tregon që, të diplomuarit e Rajonit Qendror, rezultonin të punonin në një vend pune që lidhej me studimet e tyre, përkundrejt të gjithë rajoneve të tjera, ndërsa të diplomuarit e Rajonit Juglindor, rezultonin të punonin në një vend pune jashtë profilit të tyre të studimit.

- Të diplomuarit meshkuj rezultojnë në punonin në një vend pune që lidhet me profilin e studimeve të tyre në krahasim me të diplomuarat femra. 52.7% e meshkujve, punonin në një punë relevante në krahasim me vetëm 37.9% të femrave.
- 79.1% e të diplomuarve në Hoteleri-Turizëm dhe 63.2% e të diplomuarve në SHMT, punonin në një fushë relevante me studimet e tyre, përkundrajt rreth një të tretës së të diplomuarve në TIK (35.6%) dhe në Ekonomi-Biznes (31.3%). Kjo mund t'i atribuohet faktit se, pjesa më e madhe e të diplomuarve nga këto dy drejtime, vazhdojnë studimet e larta, ndaj punësimi i tyre mund të jetë me kohë të pjesshme dhe jashtë fushës së studimit.
- Të pyetur nëse shkolla i ka ndihmuar për të gjetur punë, për të katërta rajonet, perceptimi i përgjithshëm (52.2%), është se shkolla nuk i ka ndihmuar; ku më e theksuar paraqitet në Rajonin Jugperëndimor.
- Për sa i përket të diplomuarve të cilët vazhdojnë studimet e mëtejshme, 94.6% e tyre vazhdojnë studimet universitare, dhe vetëm 5.2% e tyre, vazhdojnë formim profesional. Raportin më të lartë të të diplomuarve që vazhdojnë universitetin, e ka Rajoni Qendror me 95.8%.
- Meshkujt (95.8%) kishin një tendencë relativisht më të lartë për të vazhduar studimet e mëtejshme universitare krahasuar me femrat (91.2%). Ndërsa, femrat janë më të prirura për formim të vazhduar profesional përkundrajt meshkujve.
- 76% e të diplomuarve që vazhdojnë studime apo trajnime të mëtejshme, deklarojnë se fusha e studimeve të tyre aktuale lidhen me studimet e tyre të mëparshme, ku më e theksuar paraqitet në Rajonin Jugperëndimor (83.3%).
- Më shumë se gjysma e të diplomuarve ose 55.7% ka zgjedhur të vazhdojë studimet e mëtejshme për të arritur një kualifikim më të lartë. Kjo paraqitet si arsyeja kryesore në të gjitha rajonet, por është më shumë e theksuar në Rajonin Jugperëndimor, me 64.8% të të diplomuarve.
- Të diplomuarit e papunë që kanë kërkuar për një punë gjatë 4 javëve para momentit të anketimit, pohojnë se mënyra më e shpeshtë që ata kanë përdorur për të kërkuar punë, është nëpërmjet njohjeve familjare dhe miqësore (80,0%) dhe lajmërimeve të publikuara në mediat e ndryshme (68,3%).
- Arsyeja kryesore që të diplomuarit e papunë nuk kanë kërkuar për një punë gjatë 4 javëve të fundit para pyetësorit, është plani për t'u larguar nga vendi (47.0% kanë pohuar kështu). Planet për emigrim janë më të theksuara në Rajonin Verior (56.7%) dhe atë Juglindor (47.9%).
- 75.4% e të diplomuarve, do të zgjidhnin sërish të njëjtën shkollë nëse do të kishin mundësi, dhe ky perceptim nuk shfaq dallime të theksuara bazuar në gjini.
- Aftësitë teorike dhe praktike të stafit mësimdhënës dhe metodat e mësimdhënies, vlerësohen shumë ose jashtëzakonisht shumë nga 93.4% dhe 90.5% e të gjithë të diplomuarve të anketuar përkatësisht, ndërsa praktikat në shkollë dhe në biznese, nga mbi 87% e të anketuarve.
- Femrat janë më shumë të prirura të vlerësojnë aspekte më akademike, si kurrikulat, tekstet mësimore, infrastruktura, dhe aspekte të mësimdhënies.

Ndërkohë, meshkujt, më shumë se femrat, vlerësojnë aspekte më praktike dhe që janë të lidhura me punësimin si praktika në biznes, këshillimi i karrierës, dhe bashkëpunimi i shkollës me bizneset apo Zyrat e Punës.

- Të pyetur rreth pritshmërive të tyre për 2 vitet e ardhshme, në 24.8% të rasteve, të diplomuarit dëshironin të kishin filluar një biznes tyrin, ndërsa 23.1%, të kishin emigruar jashtë vendit. Ndarja sipas rajoneve tregon dallime të larmishme.

Lista e tabelave

Tabela 1 Parashikimi i optimizimit në 4 rajone sipas shkollave	18
Tabela 2 Shpërndarja sipas gjinisë	19
Tabela 3 Shpërndarja sipas drejtimeve mësimore	19
Tabela 4 Shpërndarja sipas rajoneve	20
Tabela 5 Statusi i punësimit sipas gjinisë, 2021	23
Tabela 6 Statusi i punësimit sipas gjinisë, 2020	23
Tabela 7 Situata aktuale e punësimit sipas rajoneve	24
Tabela 8 Statusi i punësimit sipas grupeve (% Po)	27
Tabela 9 Puna e parë pas mbarimit të shkollës (si % e të diplomuarve që janë të punësuar)	28
Tabela 10 Koha pas diplomimit për hapjen e biznesit	29
Tabela 11 Koha pas diplomimit për hapjen e biznesit (sipas gjinisë)	29
Tabela 12 Të punësuar në biznes	30
Tabela 13 Mënyra e gjetjes së punës të parë, 2021	31
Tabela 14 Mënyra e gjetjes së punës të parë, 2020	31
Tabela 15 Numri i punonjësve në kompaninë ku të diplomuarit punojnë	33
Tabela 16 Lloji i kontratës së punës	33
Tabela 17 Perceptimi i sigurisë (stabilitet) në punën aktuale	34
Tabela 18 Perceptimi i sigurisë (stabilitet) në punën aktuale sipas gjinisë	34
Tabela 19 Perspektiva e vetëpunësimit	35
Tabela 20 Përputhshmëria e punës me fushën e studimit	40
Tabela 21 Përputhshmëria e fushës së aktivitetit të vetëpunësimit me studimet	40
Tabela 22 Shkalla e përdorimit të njohurive të fituara gjatë studimeve në punën aktuale, 2021	42
Tabela 23 Shkalla e përdorimit të njohurive të fituara gjatë studimeve në punën aktuale, 2020	42
Tabela 24 Ndhurma nga shkolla për të gjetur punë	43
Tabela 25 Institucioni arsimor	45
Tabela 26 Arsyet kryesore të ndjekjes së studimeve/trajnitimit sipas rajoneve	46
Tabela 27 Arsyet kryesore të ndjekjes së studimeve/trajnitimit sipas gjinisë	47
Tabela 28 Mënyra e të kërkuarit për punë	48
Tabela 29 Mënyra e të kërkuarit për punë sipas gjinisë	48
Tabela 30 Arsyeja e të moskërkuarit për punë	49
Tabela 31 Arsyeja e të moskërkuarit për punë sipas gjinisë	49
Tabela 32 Arsyeja e mosregjistrimit tek Zyra e Punës sipas rajoneve	51
Tabela 33 Largimi nga puna e fundit sipas rajoneve	55
Tabela 34 Arsyeja kryesore e largimit nga puna e fundit sipas rajoneve	55
Tabela 35 Fushat që vlerësohen 'shumë dhe jashtëzakonisht shumë' sipas rajoneve, 2021	58
Tabela 36 Fushat që vlerësohen 'aspak/pak' sipas rajoneve, 2021	58
Tabela 37 Fushat që vlerësohen 'shumë dhe jashtëzakonisht shumë' përmirësim sipas gjinisë	59
Tabela 38 Pritshmëritë për 2 vitet e ardhshme (%) sipas rajoneve	60

Lista e figurave

Figura 1 Situata aktuale e punësimit, 2020-2021	22
Figura 2 Statusi i punësimit sipas drejtimit, 2020 - 2021	26
Figura 3 % e të diplomuarve të punësuar që kanë gjetur punë deri në 3 muaj pas diplomimit	28
Figura 4 Gjetja e punës së parë sipas gjinisë	32
Figura 5 Perceptimi i sigurisë (stabilitet) në punën aktuale sipas drejtimit	35
Figura 6 Perspektiva e vetëpunësimit sipas gjinisë	36
Figura 7 Niveli i pagave (neto) sipas rajoneve, 2021	37
Figura 8 Niveli i pagave (neto), 2020-2021	37
Figura 9 Niveli i pagave sipas gjinisë, 2021	38
Figure 10 Niveli i pagave sipas gjinisë, 2020	38
Figura 11 Niveli i pagave sipas drejtimeve, 2021	39
Figura 12 Figura 10 Niveli i pagave sipas drejtimeve, 2020	39
Figura 13 Përputhshmëria e fushës së aktivitetit të vetëpunësimit me studimet sipas gjinisë (% Po)	40
Figura 14 Lidhja e punës me studimet sipas gjinisë	41
Figura 15 Lidhja e punës me studimet sipas drejtimit (% Po)	41
Figura 16 Shkalla e përputhshmërisë së pozicionit aktual me studimet, 2020-2021	43
Figura 17 Të diplomuarit që vazhdojnë studime të mëtejshme sipas institucioneve arsimore dhe rajoneve	44
Figura 18 Të diplomuarit që vazhdojnë studime të mëtejshme sipas gjinisë	45
Figura 19 Lidhja e fushës së studimeve me studimet e mëparshme sipas rajoneve	46
Figura 20 Të diplomuar të papunë (në kërkim të një pune 4 javët e fundit) sipas rajoneve	47
Figura 21 Punëkërkuar të papunë të regjistruar tek Zyra e Punës	50
Figura 22 Punëkërkuar të papunë të regjistruar tek Zyra e Punës sipas rajoneve (% Jo)	50
Figura 23 Ansyeja e mosregjistrimit tek Zyra e Punës sipas rajoneve	51
Figura 24 Ndhimja e Zyrës së Punës për të gjetur një punë	52
Figura 25 Ndhimja e Zyrës së Punës për të gjetur një punë sipas rajoneve	52
Figura 26 Ndhimja e Zyrës së punës për të gjetur një punë sipas gjinisë	53
Figura 27 Punësuar ose jo që nga koha e diplomimit/mbarimit të shkollës	53
Figura 28 Punësuar ose jo që nga koha e diplomimit/mbarimit të shkollës sipas rajoneve	53
Figura 29 Largimi nga puna e fundit	54
Figura 30 Largimi nga puna e fundit sipas gjinisë	54
Figura 31 Specifikime të arsyes “Tjetër”	55
Figura 32 Zgjedhja e të njëjtës shkollë sipas gjinisë, 2021	56
Figura 33 Zgjedhja e të njëjtës shkollë sipas gjinisë, 2020	56
Figura 34 Zgjedhja e të njëjtës degë/drejtimit sipas gjinisë	57
Figura 35 Zgjedhja e të njëjtës degë/drejtimit sipas drejtimeve (% Po)	57
Figura 36 Pritshmëritë për 2 vitet e ardhshme, 2020-2021 (%)	60
Figura 37 Pritshmëritë për 2 vitet e ardhshme (%) sipas gjinisë	61

Lista me akronimet

AFP	Ansimi dhe Formimi Profesional
AKPA	Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive
IoAFP	Institucionet Ofruese të Ansimit dhe Formimit Profesional
S4J	Projekti 'Aftësi për Punë'
SHMT	Shërbime Mjetesh Transporti
TIK	Teknologji Informacioni dhe Komunikimi

1. HYRJE

Monitorimi i treguesve kryesorë të tregut të punës për të diplomuarit apo të certifikuarit e një institucioni arsimor, realizohet nëpërmjet ‘studimeve gjurmuese’, që ndjekin ose ‘gjurmojnë’ të diplomuarit pasi ata diplomohen/certifikohen. Gjurmimi i të diplomuarve, është një praktikë e konsoliduar dhe standarde në sektorin e Arsimit dhe Formimit Profesional (AFP) në Evropë. Të dhënat nga studimet gjurmuese, përdoren për të rritur kuptueshmërinë mbi relevancën e ofertës për kualifikime, duke kontribuar kështu, në zhvillimin e aftësive të kërkuara nga tregu i punës dhe në pajisjen e nxënësve me njohuritë dhe aftësitë e duhura (shiko për shembull Schomburg, 2016)¹.

Në Shqipëri, ndryshimet në vitet e fundit në kuadrin rregullator dhe të politikave, kanë filluar të zëvendësojnë praktikad ad hoc të gjurmimit me praktika sistematike dhe standarde, si në nivel kombëtar, ashtu edhe në nivel institucioni arsimor apo ofruesi. Në nivelin e politikave, në Strategjinë Kombëtare për Punësim dhe Aftësi 2014-2020, ngritja e një sistemi gjurmimi me ndjeshmëri për çështjet gjinore për të diplomuarit nga AFP (nga kualifikimi bazë dhe më tej) u listua si objektivi nën Përparësinë Strategjike D të Fuqizimit të qeverisjes së tregut të punës dhe sistemeve të kualifikimit.² Në përputhje me ligjin nr. 15/2017 ‘Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë’ dhe VKM nr. 554 datë 31.07.2019 “Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive”, është institucionalizuar gjurmimi në nivel kombëtar me Agjencinë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive (AKPA), përgjegjëse për kryerjen e studimeve për gjurmimin e të diplomuarve të AFP-së. Ndërkohë, institucionet ofruese të Arsimit dhe Formimit Profesional (IoAFP), janë përgjegjëse nëpërmjet Njesisë së zhvillimit për gjurmimin në nivel ofruesi.

Studimet e gjurmimit ofrojnë një tablo më të qartë të performancës së të diplomuarve të AFP-së në tregun e punës, duke matur punësimin produktiv të të diplomuarve pas përfundimit të studimeve. Ato përfaqësojnë një nga burimet e rëndësishme për vlerësimin dhe mbështetjen në përmirësimin e cilësisë dhe përputhshmërisë së AFP-së me tregun e punës. Tematikat e gjurmimit janë të shumëfishta, por kryesisht përfshijnë pyetje që lidhen me tranzicionin nga institucioni arsimor në tregun e punës, kushtet e punës, përputhjen midis arsimit dhe punës aktuale, si dhe vlerësimin në retrospektivë të institucionit arsimor, nisur nga përvoja e të diplomuarve.

Në këtë kuadër, AKPA me mbështetjen e projektit Skills for Jobs (S4J), ndërmon gjurmimin në nivel kombëtar të të diplomuarve të brezit 2020-2021 nga shkollat publike të arsimit profesional në 12 qarqet e Shqipërisë, me qëllimin e përgjithshëm të monitorimit të treguesve kryesorë të tregut të punës për të diplomuarit nga sistemi i AP-së.



1 Marrë nga: <https://www.etf.europa.eu/en/publications-and-resources/publications/carrying-out-tracer-studies-guide-anticipating-and-matching>

2 Objektivi D3.2. Marrë nga: https://financa.gov.al/wp-content/uploads/2018/06/Strategjia_Kombetare_per_Punesim_dhe_Aftesi_Plani_Veprimet.pdf

Objektivat specifike të gjurmimit në nivel kombëtar, mund të përmbliken si më poshtë:

- Vlerësimi i statusit të përgjithshëm të punësimit të të diplomuarve nga AP-ja;
- Vlerësimi i diferencave në statusin e punësimit sipas gjinisë, rajoneve, apo sektorit të ekonomisë;
- Identifikimi i treguesve specifikë rreth integritetit në tregun e punës për të diplomuarit, si koha mesatare në gjetjen e punës së parë, mënyrat e gjetjes së punës së parë, profili i punës etj.
- Analizimi i të diplomuarve të punësuar në lidhje me tipare si përputhshmëria e studimeve me vendin e punës, paga, kushtet e punës etj.
- Analizimi i të diplomuarve që zgjedhin të ndjekin kualifikime të mëtejshme pas diplomimit;
- Vlerësimi i institucioneve ofruese, bazuar në perceptimin retrospektiv të të diplomuarve;
- Krijimi i një baze për studimet dhe analizat e mëtejshme gjurmuese në nivel kombëtar për të krijuar një standard në këtë drejtim.

1283 të diplomuar nga 34 shkolla të arsimit profesional, iu përgjigjën sondazhit të gjurmimit gjatë periudhës maj-qershor 2021 ose 11-12 muaj pas diplomimit të tyre. Ky raport përshkruan dhe analizon të dhënat dhe rezultatet e përgjithshme mbi rrugëtimin profesional të të diplomuarve pas mbarimit të studimeve, integrimin e tyre në tregun e punës, si dhe aspekte të tjera që mund të ndihmojnë drejt vlerësimit të orientimit drejt tregut të sistemit të AFP-së në Shqipëri. Rezultatet kryesore janë paraqitur në përputhje me objektivat e studimit të gjurmimit. Ndërkohë, analizohen edhe krahasime në kohë me brezin e mëparshëm të gjurmuar.

Raporti është strukturuar si më poshtë vijon. Seksioni në vijim, përshkruan metodologjinë e ndjekur për gjurmimin kombëtar. Më tej analizohen në detaj rezultatet për a) kategorinë e të diplomuarve të punësuar, b) të diplomuarve që ndjekin kualifikime të mëtejshme, c) të diplomuarve pa punë, si dhe d) perceptimet mbi vlerësimin e institucioneve bazuar në vlerësimin retrospektiv të të diplomuarve. Në seksionin përmbyllës, jepen rezultatet e përgjithshme dhe rekomandimet kryesore.

2. METODOLOGJIA

Qasja metodologjike

Për studimin e gjurmimit kombëtar të të diplomuarve nga shkollat e arsimit profesional u përdor një model hulumtimi i tërthortë, ku të dhënat u mbledhën nëpërmjet pyetësorëve të standardizuar përgjatë muajve maj-qershor 2022. Popullata e cila u studiu, janë të diplomuarit në vitin 2021 nga shkollat publike të arsimit profesional.

Ky nuk është studimi i parë që kryhet për këtë grup të synuar. Para vitit 2021, këto studime janë realizuar duke përdorur një kampion në bazë të numrit total të të diplomuarve. Në vitin 2021, duke marrë parasysh nevojat për të gjeneruar indikatorë të analizuar në nivel: rajoni, grupi social, drejtimi mësimor etj., u realizua censusi i popullatës në vend të përzgjedhjes së një kampioni. Gjatë këtij procesi, madhësia e popullatës së synuar ishte e vogël në numër: rreth 4101 nxënës të diplomuar nga 36 shkolla në vitin 2020. Në fund të anketimit, informacioni i mbledhur mbuloi 1412 të diplomuar ose 34% të tyre. Pjesa më e madhe, si pasojë e kontakteve të gabuara, ndërsa një pjesë tepër e vogël, si pasojë e refuzimit.

Duke pasur parasysh eksperiencën e vitit të kaluar fillimisht u realizua një pilotim demografik për të kuptuar nivelin e përgjigjeve. Në bazë të kësaj, do të merrej vendimi nëse do të ribëhej përsëri census, apo do të shkohej me një kampion. Gjatë pilotimit demografik, niveli i përgjigjeve ishte 39%. Në bazë të këtij rezultati, u mor vendimi të kryhet përsëri një census në mënyrë që të merret një informacion i plotë dhe që çdo i diplomuar të ketë të njëjtën mundësi pjesëmarrjeje në studim, si dhe për të pasur të dhëna sa më të sakta statistikisht, si në nivel kombëtar ashtu edhe në atë rajonal.

Për kontaktin e të diplomuarve, u përdor baza e të dhënave të disponueshme e siguruar nga AKPA. Popullata përfshinte 3809 nxënës, që kishin mbaruar studimet gjatë vitit 2021. 33.6% e të diplomuarve në vitin 2021, u anketuan 11-12 muaj pas diplomimit të tyre. Kjo periudhë mund të konsiderohet e mjaftueshme që të diplomuarit të jenë integruar në tregun e punës, ose të jenë në kërkim aktiv të një pune.

Instrumenti i studimit - pyetësoni

Të dhënat për studimin e gjurmimit u bazuan në një pyetësor të standardizuar, të organizuar me blloqe kryesore pyetjesh, ashtu si dhe gjatë vitit 2021.

Duke pasur parasysh eksperiencën e vitit të kaluar, në pyetësor u bënë disa nishikime, si në lidhje me përmbajtjen, ashtu edhe me mënyrën e organizimit. Megjithatë, është pasur parasysh që, ndryshimet e bëra, të ishin të tilla që të lejohej krahasimi me të dhënat e përfutuara një vit më parë.

Duke u nisur nga fakti se qëllimi kryesor i anketimit ishte të studiohej përfshirja e nxënësve të diplomuar në tregun e punës, pyetja kryesore ishte statusi i tyre në momentin e anketimit.

Grupet në të cilat ndaheshin të anketuarit ishin:

- të punësuar (të punësuar, studentë që punonin dhe studionin në të njëjtën kohë)

- të vetëpunësuar
- të papunë aktivë
- joaktivë (studentë, shtëpiakë, të dekurajuar, PAK)

Secili nga grupet, kishte bllokun e pyetjeve në përputhje me karakteristikat përkatëse.

Disa nga pyetjet për grupin e parë dhe të dytë (të diplomuarit në marrëdhënie pune), ishin:

- koha e gjetjes së punës ose e hapjes së biznesit
- mënyra e gjetjes së punës ose e hapjes së biznesit
- përputhja e drejtimit me vendin e punës
- intervali i pagës
- dobia e njohurive të marra në shkollë në vendin e punës
- siguria dhe kënaqshmëria me vendin e punës

Për grupin e tretë ose të papunët:

- perceptimi mbi statusin
- roli i zyrave të punës për të gjetur punë

Për grupin e fundit ose të diplomuarit ekonomikisht joaktivë, rëndësi të veçantë kishin si të dekurajuarit, ashtu edhe ata që po ndiqnin kualifikime të mëtejshme. Për të dekurajuarit, qëllimi ishte të merrej informacion pse ata nuk e mendonin veten të aftë për të gjetur një punë, ndërsa për ata që po ndiqnin kualifikime të mëtejshme: lloji i kualifikimit, arsyeja e ndjekjes së studimeve, si dhe lidhja e tyre me drejtimin profesional.

Për të gjithë të anketuarit pavarësisht statusit të punësimit, u drejtua një grup i njëjtë pyetjesh mbi:

- nevojën për përmirësime në aspekte të veçanta në shkollë
- perspektivën e tyre për të ardhmen profesionale.

Ashtu si dhe në anketimin e mëparshëm, u përdorën intervistat telefonike, me anë të një teknike të njohur si CATI (Computer-assisted telephone interviewing), në të cilën intervistuesi telefonon të anketuarin dhe regjistron përgjigjet e tij në një aplikacion kompjuterik, i cili administrohet online nëpërmjet përdorimit të Platformës Kobo Toolbox³.



3 <https://www.kobotoolbox.org/>

Për kryerjen e pyetësorit për të diplomuarit u angazhuan dy persona, të cilët u trajnuan nga eksperti i metodologjisë për mënyrën e duhur të administrimit. Pyetësi zgjaste mesatarisht rreth 6 minuta.

Analizimi i të dhënave

Pas mbledhjes së të dhënave, u realizua pastrimi, tabulimi dhe analizimi i tyre, duke përdorur programin statistikor SPSS. Tabulimi dhe analiza përfshijnë:

- përshkrimin deskriptiv të të dhënave nëpërmjet tabelave dhe grafikëve të ndryshëm.
- krahasimin me brezin e mëparshëm të gjurmuan.

Rezultatet janë paraqitur dhe analizuar në raport në agregat dhe sipas parashikimeve të ndarjes rajonale të optimizimit të ofruesve të AFP-së, që i ndajnë ofruesit në 4 rajone siç tregohet më poshtë.




Tabela 1 Parashikimi i optimizimit në 4 rajone sipas shkollave

Rajoni Verior	Rajoni Qendror	Rajoni Jugperëndimor	Rajoni Juglindor
Hamdi Bushati	Beqir Cela	Industriale “Pavarësia”	Demin Progri
Arben Broci	Hysen Cela	Tregtare, Vlorë	Shkolla e Ndërtimit, Korçë
Kole Mangjini	26 marsi	Antoni Athanas	Fan Noli
Ndre Mjeda	Shkolla e Mesme Kombëtare e Agrobiznesit, Golem	Thoma Papapano	Isuf Gjata
Kolin Gjoka	Hoteleri-Turizëm, Tiranë	Petro Sota	Irakli Terova
Nazmi Rushiti	Teknike-Ekonomike, Tiranë	Rakip Kryeziu	Enver Qiraxhi
Havzi Nela	Gjergji Canco	Shkolla Mekanike, Lushnjë	Kristo Isak
Industriale, Rubik	Hermann Gmeiner		Stiliano Bandilli
	Karl Gega		Ali Myftiu
	Qendra Shumëfunk- sionale, Kamëz		Salih Çeka
			Mihal Shahini

Kufizimet metodologjike

Bazuar në faktin që anketa duhej të ishte census, të dhënat duhej të merrreshin për të tërë popullatën, por vetëm 33.6% e të diplomuarve në vitin 2021, arritën të intervistoheshin. Kjo shkallë më e ulët vjen kryesisht si pasojë e: kontakteve të paplota dhe të gabuara në disa raste në databazën e popullatës. Megjithatë, 33.6% e të diplomuarve ose 1283, është një numër me të cilin mund të kryen analiza të sakta dhe mund të nxirren përfundime pasi të dhënat janë përfaqësuese.

Bazuar në këto analiza, studimet e gjurmimit në vijim, mund të kryen me kampionim.

3. PËRSHKRIMI I DEMOGRAFISË

Bazuar në të dhënat e mbledhura, më poshtë paraqitet analiza demografike rreth shpërndarjes së të anketuarve. Në tabelën 3 jepet shpërndarja e të diplomuarve dhe të anketuarve sipas gjinisë. Nga të dhënat e tabelës, 81.1% e të diplomuarve nga shkollat e arsimit profesional në vitin 2021, ishin meshkuj, ndërsa vetëm 18.9%, ishin femra. Afërsisht, kjo lloj përqindjeje është ruajtur edhe te të diplomuarit që i janë përgjigjur pyetësorit: ku 16.9% ishin femra, ndërsa 83.1%, meshkuj.

Tabela 2 Shpërndarja sipas gjinisë

Gjinia	% e të diplomuarve	Të anketuarit	% e të anketuarve
Femër	18.9	217	16.9
Mashkull	81.1	1066	83.1
Total	100.0	1283	100

Ndërkohë, 34 nga 1283 të diplomuarit e anketuar, ose 2.7%, i përkisnin një pakice kombëtare. Pjesa dërrmuese e pakicave kombëtare (88%), i përkisnin komunitetit Rom dhe Egjiptian. Gjashtë të anketuar ishin individë me aftësi ndryshe (aftësi e kufizuar intelektuale, dëmtime ortopedike dhe sëmundje kronike) dhe përfitonin pagesën për aftësinë e kufizuar (PAK). Statusi i jetimit disponohet nga 47 të anketuar ose 3.7%.

Mbi gjashtëdhjetë për qind (63.9%) e të anketuarve, kanë ndjekur 5 nga 20 drejtimet mësimore duke reflektuar kështu përgjithësisht edhe përqindjet në popullatë (60.1%). Drejtimi më i përfaqësuar, është Shërbime Mjetesh Transporti me 18.7%, ndjekur nga Hoteleri-Turizëm me 16.6%, Teknologji Informacioni dhe Komunikimi (TIK) me 10.9%, Elektroteknika me 9.4%, dhe Ekonomi-Biznes me 8.3%.

Tabela 3 Shpërndarja sipas drejtimeve mësimore

Drejtimi	Të anketuarit	% e të anketuarve
Shërbime Mjetesh Transporti	240	18.7
Hoteleri-Turizëm	213	16.6
Teknologji Informacioni dhe Komunikimi (TIK)	140	10.9
Elektroteknikë	121	9.4
Ekonomi-Biznes	107	8.3
Mekanikë	74	5.8
Teknologji Ushqimore	67	5.2
Shërbime Sociale dhe Shëndetësore	56	4.4
Termohidraulikë	54	4.2
Bujqësi	45	3.5

Drejtimi	Të anketuarit	% e të anketuarve
Veterinari	35	2.7
Tekstil-Konfeksione	27	2.1
Inxhinieri Informatike Software	24	1.9
Ndërtim	22	1.7
Përpunim druri	19	1.5
Elektronikë	12	0.9
Kërkim, shpim dhe shfrytëzim nafte	11	0.9
Gjeodezi	8	0.6
Pyje	8	0.6
Total	1283	100.0

Shpërndarja e të anketuarve sipas rajoneve, tregon se, më shumë se gjysma e të anketuarve (60.5%), i përkasin Rajonit Qendror, ndjekur nga Rajoni Juglindor dhe Jugperëndimor, që kanë një shpërndarje të njëjtë të të anketuarve (përkatësisht 14.4% dhe 14.7%). Ndërsa, Rajoni Verior, është më pak i përfaqësuar, me vetëm 10.4% të të anketuarve.

Tabela 4 Shpërndarja sipas rajoneve

Rajonet	Të anketuarit	% e të anketuarve
Rajoni Verior	133	10.4
Rajoni Qendror	776	60.5
Rajoni Juglindor	185	14.4
Rajoni Jugperëndimor	189	14.7
Total	1283	100




4. REZULTATET

4.1 SITUATA E PUNËSIMIT E TË DIPLOMUARVE

Situata aktuale e punësimit

Shpërndarja sipas statusit të punësimit tregon se, në total, afërsisht 6 në 10 të diplomuar nga arsimi profesional në vitin 2022, ose 57.5% e të diplomuarve ishin në marrëdhënie pune 1 vit pas diplomimit, nga të cilët 38.3% ishin të punësuar me pagë, 8% ishin të vetëpunësuar, ndërsa 11.2% punonin dhe studionin në të njëjtën kohë. 23.5% e të diplomuarve ndiqnin kualifikime të mëtejshme si studentë apo kursantë. Ndërkohë, vetëm 7.7% ishin të papunë që po kërkonin aktivisht për punë në momentin e zhvillimit të anketës. Për sa i përket situatës së punësimit të të diplomuarve në vitin 2020, më pak të diplomuar ishin të punësuar (30.9%), të vetëpunësuar (4.4%) ose duke punuar dhe studiuar në të njëjtën kohë (4.9%) krahasuar me vitin 2021. Gjithashtu, të diplomuar të papunë në kërkim të një pune ishin pothuajse trefish më shumë së kohorta e vitit 2021. Dallime paraqiten edhe për kategorinë e të diplomuarve në kualifikime apo studime të mëtejshme, ku 28.5% të diplomuar në vitin 2020, ishin sërish studentë apo kursantë, krahasuar me 23.5% të diplomuar në vitin 2021.

Figura 1 Situata aktuale e punësimit, 2020-2021



Baza e përgjigjeve 2021: N=1283

Baza e përgjigjeve 2020: N=1412

Shënim: Rezultatet në raport janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%.

Të dhënat e analizuar (Tabela 5) tregojnë dallime në shpërndarjen e statusit të punësimit sipas gjinisë. Të diplomuarit meshkuj, ishin më të prirur se të diplomuarat femra për të qenë të punësuar, me 59.8% të meshkujve të punësuar përkundërt 46.1% të femrave. Për të diplomuarit e vitit 2020, hendeku gjinor është më i thelluar, ku 43.7% meshkuj dhe vetëm 18.1% femra, ishin të punësuar. Gjithashtu, meshkujt e papunë ishin më të prirur për të kërkuar punë, me një ndryshim të vogël përkundërt femrave, vetëm 2.5 pikë përqindje më shumë. Krahasuar me vitin 2020, më shumë

meshkuj të papunë se femra, ishin të prirur të kërkonin për një vend pune, por hendeku ishte më i thelluar me 10.2% pikë përqindje më shumë. Ndërkohë, femrat ishin më të prirura për të qenë ekonomikisht joaktive (47.5% e femrave krahasuar me 32.3% e meshkujve). Më shumë femra të diplomuara në vitin 2020 (67.5%), ishin të prirura të ishin ekonomikisht joaktive krahasuar me të diplomuarat në vitin 2021, ndërsa nuk paraqiten ndryshime në të dhënat për meshkujt nga viti në vit. Arsyeja kryesore e të qenit joaktivë për të dyja gjinitë, lidhet me përfshirjen në arsim dhe trajnim të mëtjshëm, por për popullsinë e femrave, kjo paraqitet më e theksuar, ku 36.4% ishin studente apo kursante, krahasuar me 20.9% të meshkujve. Të diplomuarat femra në vitin 2020 (58%), ishin më të prirura për të ndjekur arsim ose trajnim të mëtjshëm, krahasuar me kohortën e vitit 2021. E njëjta tendencë paraqitet dhe për të diplomuarit meshkuj, ku 24.2% ndiqnin trajnim ose arsim të mëtjshëm. Për më tepër, edhe pse në përqindje të vogla për të dyja gjinitë, femrat ishin më të prirura për t'u angazhuar në përmbushjen e detyrave shtëpiake (0,9% krahasuar me 0.2% në vitin 2021, dhe 6.2% krahasuar me 0.2% në vitin 2021). Kjo konfirmon tendencën e të diplomuarave femra, për të ulur pjesëmarrjen e tyre në përmbushjen e detyrave familjare nga viti në vit, ndërsa për meshkujt, nuk ka ndryshime.

Tabela 5 Statusi i punësimit sipas gjinisë, 2021

	Total		Mashkull		Femër	
	N	%	N	%	N	%
Të punësuar	737	57.5%	59.8%		46.1%	
I/E punësuar	491	38.3%	40.4%		27.6%	
I/E vetëpunësuar	102	8.0%	9.1%		2.3%	
Punoj dhe studioj në të njëjtën kohë	144	11.2%	10.2%		16.1%	
Pa punë dhe po kërkoj për punë	99	7.7%	8.0%		6.5%	
Joaktivë	447	34.8%	32.3%		47.5%	
Pa punë por nuk kërkoj për punë	139	10.8%	11.0%		10.1%	
Student/Kursant	302	23.5%	20.9%		36.4%	
Në paaftësi të përhershme	1	0.1%	0.1%		0.0%	
Duke përmbushur detyrat shtëpiake	3	0.2%	0.1%		0.9%	
Tjetër	2	0.2%	0.2%		0.0%	
TOTAL	1283	100.0%	100.0%		100.0%	

Tabela 6 Statusi i punësimit sipas gjinisë, 2020

	Total		Mashkull		Femër	
	N	%	N	%	N	%
Të punësuar	565	40.2%	530	43.7%	35	18.1%
I/E punësuar	434	30.8%	409	33.7%	25	13.0%
I/E vetëpunësuar	62	4.4%	61	5.0%	1	0.5%

	Total		Mashkull		Femër	
	N	%	N	%	N	%
Punoj dhe studioj në të njëjtën kohë	69	4.9%	60	4.9%	9	4.7%
Pa punë dhe po kërkoj për punë	321	22.8%	294	24.2%	27	14.0%
Joaktivë	521	37%	390	32.1%	131	67.9%
Pa punë por nuk kërkoj për punë	100	7.1%	93	7.7%	7	3.6%
Student/Kursant	406	28.9%	294	24.2%	112	58.0%
Duke përmbushur detyrat shtëpiake	14	1.0%	2	0.2%	12	6.2%
Tjetër	1	0.1%	1	0.1%	0	0.0%
TOTAL	1407	100.0%	1214	100.0%	193	100.0%

Edhe ndarja sipas rajoneve shpërfaq ndryshime në statusin e punësimit të të diplomuarve pas mbarimit të arsimit profesional. Të diplomuarit e Rajonit Qendror, rezultojnë të punësuar pas diplomimit, krahasuar me rajonet e tjera, nga ku më shumë se gjysma, 60.1% e të diplomuarve, ishin të punësuar, duke u ndjekur nga Rajoni Jugperëndimor me një diferencë shumë të vogël prej 0.8 pikë përqindje. Të diplomuarit e papunë në Rajonin Verior dhe Juglindor, rezultojnë më aktivë në kërkimin e një pune, në krahasim me rajonet e tjera. Ndërkohë, Rajoni Juglindor dhe Jugperëndimor, tregojnë përqindje më të larta të joaktivitetit (përkatesisht, 41.1% dhe 36%). Arsyeja kryesore e të qenit joaktivë për të katërta rajonet, lidhet me prirjen për të ndjekur kualifikimet e mëtejshme: rreth një e treta e të diplomuarve në të katërta rajonet. Arsyeja e dytë e të qenit joaktivë, lidhet me faktin e moskërkimit të një pune në popullsinë e të diplomuarve të papunë, ku Rajoni Juglindor shënon përqindjen më të lartë (20.0%) krahasuar me tre rajonet e tjera.

Tabela 7 Situata aktuale e punësimit sipas rajoneve

	Rajoni Verior	Rajoni Qendror	Rajoni Juglindor	Rajoni Jugperëndimor
Të punësuar	54.1%	60.1%	47%	59.3%
I/E punësuar	38.3%	39.6%	28.6%	42.3%
I/E vetëpunësuar	8.3%	6.3%	11.4%	11.1%
Punoj dhe studioj në të njëjtën kohë	7.5%	14.2%	7.0%	5.8%
Pa punë dhe po kërkoj për punë	12.0%	6.7%	11.9%	4.8%
Joaktivë	33.8%	33.2%	41.1%	36.0%
Pa punë por nuk kërkoj për punë	13.5%	7.6%	20.0%	13.2%
Student/Kursant	18.8%	25.3%	20.5%	22.8%


Në paaftësi të përhershme	0.0%	0%	0.5%	0.0%
Duke përmbushur detyrat shtëpiake	0.8%	0.3%	0.0%	0.0%
Tjetër	0.8%	0.1%	0.0%	0.00%

Ndaj sipas sektorëve tregon dallime në statusin e punësimit dhe përfshirjen në tregun e punës në varësi të drejtimit profesional që kanë ndjekur të diplomuarit. Grafiku 2 më poshtë, paraqet statusin e punësimit të të diplomuarve sipas drejtimeve, për drejtimet profesionale me më shumë se 100 të diplomuar të anketuar. Nga viti 2020 në vitin 2021, vërehet se, Mekanika, ka më pak se 100 të diplomuar të anketuar. Të dhënat aktuale tregojnë se të diplomuarit në Hoteleri-Turizëm (70%), janë më të prirur për t'u punësuar, duke konfirmuar kështu punësimin e formimeve profesionale të orientuara drejt kërkesave të tregut (Figura 3). Drejtimi hoteleri-turizëm pasohet nga drejtimet me karakter industrial, ku më shumë se gjysma e të diplomuarve të Elektroteknikës (55.4%) dhe SHMT-së (Shërbime mjetesh transporti) (63.3%), ishin tashmë të punësuar pas mbarimit të arsimit profesional. Të dhënat e punësimit sipas drejtimeve kryesore për të diplomuarit e vitit 2020, tregojnë se të diplomuarit nga drejtimet me karakter industrial, si Elektroteknika (53.3%) dhe Shërbimet e mjeteve të transportit (52.8%), ishin më të prirur për t'u punësuar në krahasim me drejtimet e tjera. Ndërsa drejtimi Hoteleri-Turizëm, renditet i treti për sa i përket punësimit të të diplomuarve.

Nivelet më të larta të joaktivitetit, tregohen në sektorin e Hoteleri-Turizmit dhe SHMT-së, përkatësisht 13.6% dhe 10.8%, ndryshe nga viti 2020, ku kryesojnë drejtimet Mekanikë (11.1%) dhe Ekonomi-Biznes (10.2%). Kërkesave të larta për arsim apo kualifikime të mëtejshme, ku më shumë se një e treta e të diplomuarve janë të prirur të zhvillojnë më shumë njohuritë e tyre në këtë drejtim, dallohen në TIK dhe Ekonomi-Biznes (përkatësisht 38.6% dhe 37.4% e të diplomuarve). Për këtë arsye, këto dy drejtime karakterizohen me përqindje të ulta të joaktivitetit për arsye të tjera. I njëjti trend paraqitet edhe për të diplomuarit e vitit 2020, por në përqindje më të larta, ku 57.8% e të diplomuarve në Ekonomi-Biznes dhe 46.7% në TIK, ishin të prirur të vazhdonin arsim apo kualifikime të mëtejshme.

Vetëm 1.4% e të diplomuarve në TIK, ishin të papunë duke kërkuar aktivisht për punë në momentin e anketimit, oka tregon se të diplomuarit e këtij profili janë ose të punësuar ose në studime të mëtejshme. Më shumë të diplomuar në SHMT (12.5%) priren të jenë të papunë por duke kërkuar aktivisht për punë në momentin e anketimit krahasuar me drejtimet e tjera. Ndërsa për të diplomuarit e vitit 2020, pak më shumë se një e pesta e të diplomuarve në SHMT, Hoteleri-Turizëm dhe Elektroteknikë ishin të papunë, por duke kërkuar aktivisht për punësim. Përqindja më e lartë vërehet në sektorin e Mekanikës ku 43.5% e të diplomuarve ishin të papunë, por në kërkim të një vendi pune. Kjo e dhënë mund të tregojë dhe zhvendosje të mundshme të Mekanikës nga renditja e drejtimeve me më shumë se 100 të diplomuar, ku për shkak të përqindjes së lartë të të diplomuarve të papunë, më pak studentë zgjedhin të studiojnë/diplomohen në Mekanikë.

Figura 2 Statusi i punësimit sipas drejtimit, 2020 - 2021



Shënim: Në grafik tregohen drejtimet që kanë më shumë se 100 të diplomuar të anketuar që kanë ndjekur atë drejtim.

Pothuajse gjysma e të diplomuarve me statusin jetim (48.9%), ishin të punësuar, dhe më shumë se një e treta e të diplomuarve me aftësi ndryshe (33.3%) dhe e të diplomuarve me statusin Rom dhe Egjiptian⁴ (38.2%), janë të punësuar. Përqindjet më të larta të të diplomuarve të papunë, por që ishin duke kërkuar për punë në momentin e anketimit, i përkasin të diplomuarve pjesë e minoriteteve të ndryshme dhe atyre me aftësi ndryshe. Për të treja kategoritë, arsyet kryesore e të mosqenët aktivë në tregun e punës, ishin kualifikimet e mëtjeshme. Për të diplomuarit me aftësi ndryshe, rreth 16.7% e tyre ishin joaktivë duke përmbushur detyrat shtëpiake, në krahasim me asnjë të diplomuar minoritar apo jetim të kësaj kategorie. Për më tepër, vërehet se nuk ka të diplomuar të anketuar me aftësi ndryshe, të cilët janë të papunë dhe nuk kërkojnë për një punë.

Në seksionet në vijim analizohen në detaj gjetjet kryesore të gjurmimit për çdo kategori punësimi.



4 Minoritetet janë cilësuar sipas ligjit.

Tabela 8 Statusi i punësimit sipas grupeve (% Po)

	Minoritarë	Me aftësi ndryshe	Jetimë
Të punësuar	38.2%	33.3%	48.9%
I/E punësuar	23.5%	16.7%	34.0%
I/E vetëpunësuar	8.80%	0.0%	2.1%
Punoj dhe studioj në të njëjtën kohë	5.90%	16.7%	12.8%
Pa punë dhe po kërkoj për punë	17.60%	16.7%	6.4%
Joaktivë	44.1%	50.0%	44.7%
Pa punë, por nuk kërkoj për punë	17.6%	0.0%	6.4%
Student/Kursant	24.20%	33.3%	38.3%
Duke përmbushur detyrat shtëpiake	0.4%	16.7%	0.0%
Tjetër	0.0%	0.20%	0.0%

4.2 TË DIPLOMUARIT E PUNËSUAR

Seksioni 4.2 paraqet rezultatet e gjurmimit për kategorinë e të diplomuarve të punësuar, duke përshtetur përvojën e tyre gjatë tranzicionit dhe integritetit në tregun e punës. Të dhënat paraqiten në total dhe të ndara sipas rajoneve.

Tranzicioni drejt tregut të punës – koha e gjetjes së punës së parë


Të dhënat e gjurmimit tregojnë se të diplomuarit nga arsimi profesional integrohen relativisht lehtë në tregun e punës. 57.5% e të diplomuarve të punësuar në vitin 2021, e kishin gjetur punën e tyre të parë që para diplomimit/mbanimit të shkollës, krahasuar me 60.5% të të diplomuarve të punësuar në vitin 2020. Gjithashtu, vihet re një rritje e konsiderueshme e të diplomuarve të kohortës së vitit 2021 (21.6%), krahasuar me kohortën e vitit 2020 (10.3%), të cilët integrohen në tregun e punës 1 muaj pas diplomimit. Ndarja sipas rajoneve tregon se, të diplomuarit e Rajonit Verior, kanë tranzicion më të ngadaltë drejt tregut të punës. Më pak se gjysma e të diplomuarve të këtij rajoni ose 46.7%, e kishin gjetur punën e tyre të parë para diplomimit, krahasuar me mbi 50% të të diplomuarve nga rajonet e tjera, ku Rajoni Qendror ka numrin më të lartë (60.8%) të të diplomuarve të punësuar. Të diplomuarit e Rajonit Verior (43.4%), kanë tendencë më të lartë krahasuar me të diplomuarit e rajoneve të tjera të punësohen 1 ose 1-3 muaj pas diplomimit. Më shumë të diplomuar në Rajonin Juglindor dhe atë Perëndimor, e fillojnë punën e tyre të parë 3-6 ose 6-9 muaj pas diplomimit, krahasuar me dy rajonet e tjera. Ndërsa, për sa i përket kohështirjes 9-12 muaj pas diplomimit, të diplomuarit e Rajonit Verior (5%) janë më të prirur të presin në afat më të gjatë për të filluar punë, krahasuar me rajonet e tjera.

Tabela 9 Puna e parë pas mbarimit të shkollës (si % e të diplomuarve që janë të punësuar)

	Rajoni Verior	Rajoni Qendror	Rajoni Juglindor	Rajoni Jugperëndimor	Total 2021	Total 2021
Që para diplomimit/mbarimit të shkollës	46.7%	60.8%	54.5%	51.6%	57.5%	60.5%
1 muaj pas diplomimit	26.7%	20.7%	24.2%	20.9%	21.6%	10.3%
1 - 3 muaj pas diplomimit	16.7%	10.3%	10.6%	13.2%	11.4%	18.9%
3 - 6 muaj pas diplomimit	5.0%	3.8%	7.6%	8.8%	5.1%	8.0%
6 - 9 muaj pas diplomimit	0.0%	1.9%	3.0%	4.4%	2.2%	1.6%
9 - 12 muaj pas diplomimit	5.0%	2.4%	0.0%	1.1%	2.2%	0.6%

Në total, rreth 9 në 10 të diplomuar të punësuar (90.5%), ishin punësuar në punën e tyre të parë brenda 3 muajve pas mbarimit të shkollës. Të diplomuarit meshkuj (91.3%), ishin më të prirur se të diplomuarat femra (86.5%), për t'u integruar në tregun e punës brenda 3 muajve pas mbarimit të shkollës.

Figura 3 % e të diplomuarve të punësuar që kanë gjetur punë deri në 3 muaj pas diplomimit



Pë sa i përket kategorisë së të vetëpunësuarve, 59.8% e të diplomuarve punonin në biznesin e familjes dhe kjo përqindje ishte më e lartë për Rajonin Jugperëndimor (76.2%) dhe Rajonin Verior (72.7%). 13.7% e kishin hapur biznesin e tyre para mbarimit të shkollës. Të diplomuarit e Rajonit Jugperëndimor (4.8%), ishin më të prirur të hapnin biznesin e tyre para diplomimit, ndërsa të diplomuarit e Rajonit Juglindor (33.3%), ishin të prirur të merrnin më shumë kohë për hapjen e biznesit, në krahasim me rajonet e tjera. Përgjithësisht, të diplomuarit e Rajonit Qendror (14.3%) dhe Jugperëndimor

(14.3%), ndërtorin bizneset e tyre në afat të shkurtër (deri në 3 muaj pas diplomimit), në krahasim me të diplomuarit e Rajonit Juglindor (9.6%). Ndërsa, të hapurit e një biznesi nga të diplomuarit e Rajonit Verior, mbetej një zgjedhje për në afat të gjatë (9-12 muaj pas diplomimit), nëse nuk ishte biznes familjar ose i ndërtuar para diplomimit.

Tabela 10 Koha pas diplomimit për hapjen e biznesit

	Rajoni Verior	Rajoni Qendror	Rajoni Juglindor	Rajoni Jugperëndimor	Total
Është biznesi i familjes	72.7%	55.1%	47.6%	76.2%	59.8%
E kam hapur para diplomimit	18.2%	8.2%	33.3%	4.8%	13.7%
1 muaj pas diplomimit	0.0%	8.2%	4.8%	4.8%	5.9%
1 -3 muaj pas diplomimit	0.0%	6.1%	4.8%	9.5%	5.9%
3 - 6 muaj pas diplomimit	0.0%	14.3%	4.8%	0.0%	7.8%
6 - 9 muaj pas diplomimit	0.0%	2.0%	4.8%	0.0%	2.0%
9 - 12 muaj pas diplomimit	9.2%	6.1%	0.0%	4.8%	4.9%

Përgjithësisht, meshkujt ishin më të prirur të punonin në bizneset familjare (60.8%) ose të hapnin një biznes para diplomimit ose 1 muaj pas diplomimit krahasuar me femrat. Ndërsa për femrat, hapja e një biznesi mbetej një zgjedhje për një kohë pak më të gjatë pas diplomimit, krahasuar me meshkujt, si psh. 1-3 muaj (20%), 3-6 muaj (40%) ose 9-12 muaj (40%) pas diplomimit.

Tabela 11 Koha pas diplomimit për hapjen e biznesit (sipas gjinisë)

	Femër	Mashkull	Total
Është biznesi i familjes	40.0%	60.8%	59.8%
E kam hapur para diplomimit	0.0%	14.4%	13.7%
1 muaj pas diplomimit	0.0%	6.2%	5.9%
1 -3 muaj pas diplomimit	20.0%	5.2%	5.9%
3 - 6 muaj pas diplomimit	40.0%	6.2%	7.8%
6 - 9 muaj pas diplomimit	0.0%	2.1%	2.0%
9 - 12 muaj pas diplomimit	40.0%	5.2%	4.9%

Të pyetur për numrin e të punësuarve në biznesin e tyre, 54.9% e të diplomuarve të vetëpunësuar, deklaruan se kishin punësuar 1-3 persona, gjë që thekson orientimin drejt sipërmarrjeve të vogla. Më shumë se një e katërta e të diplomuarve të vetëpunësuar, deklaruan se nuk kanë asnjë të punësuar, por e drejtojnë vetëm, dhe kjo është më e theksuar në Rajonin Juglindor (38.1%). Ndërsa vetëm 19.6%, ishin të

orientuara drejt sipërmarrjeve pak më të mëdha dhe kishin me shumë se 3 persona të punësuar. Kjo dukuri është më e theksuar në Rajonin Qendror (30.6%). Ndërsa, asnjë i diplomuar i vetëpunësuar në Rajonin Verior, nuk kishte sipërmarrje me më shumë se 3 persona të punësuar, por ishin më të orientuar drejt sipërmarrjeve të vogla me 1-3 punonjës.

Tabela 12 Të punësuar në biznes

	Rajoni Verior	Rajoni Qendror	Rajoni Jug-lindor	Rajoni Jug-perëndimor	Total
Asnjë	36.4%	22.4%	38.1%	14.3%	25.5%
1-3 persona	63.6%	46.9%	57.1%	66.7%	54.9%
Më shumë se 3 persona	0.0%	30.6%	4.8%	19.0%	19.6%

Tranzicioni drejt tregut të punës – mënyra e gjetjes së punës së parë

Njohjet, lidhjet familjare dhe miqtë përfaqësojnë mënyrën më të shpeshtë, se si të diplomuarit e punësuar në të katërta rajonet, e kishin gjetur punën e tyre të parë. 81.5% e të diplomuarve kishin gjetur punë nëpërmjet njohjeve dhe lidhjeve familjare. Përdorimi i këtyre kanaleve joformale, ishte i përhapur pothuajse njësoj tek të katërta rajonet, ku mbi 80% e të diplomuarve, e gjetën punën e tyre të parë nëpërmjet kontakteve familjare, ku më e theksuar vihet re tek Rajoni Jugperëndimor (84.6%). Edhe pse në përqindje të konsiderueshme më të ulët se në vitin 2021, edhe për të diplomuarit e vitit 2020, njohjet, lidhjet familjare, të njohurit dhe miqtë, mbeten kanalet më të përhapura për gjetjen e një pune, ku 58.7% e të diplomuarve kishte gjetur punë nëpërmjet këtyre kanaleve joformale. Më e theksuar ishte në Rajonin Qendror (65.4%).

Mënyra e dytë më e përdorur (7.1%), ishte nëpërmjet lajmërimeve të publikuara në faqe interneti, media sociale, gazetë etj. Kjo mënyrë ishte më e theksuar në Rajonin Qendror (8.2%) dhe më pak e përdorur në Rajonin Jugperëndimor (3.3%). Dy kanalet pasuese më të përdorura, ishin kontakti i drejtpërdrejtë me punëdhënësin nëpërmjet CV-së etj.: (5.8%), dhe nëpërmjet praktikës profesionale (4.1%). Ndryshe nga viti 2021, të diplomuarit në vitin 2020 ishin më të prirur të kontaktonin drejtpërdrejt punëdhënësin potencial, ku 24.7% e kishin gjetur punën e parë nëpërmjet aplikimeve me CV drejtpërdrejt tek punëdhënësi. Vetëm 3.3% e të diplomuarve në vitin 2020, përdorën lajmërimi të publikuara në faqe interneti, media sociale, gazetë etj., për të gjetur punën e tyre të parë. Kanalet e tjera si zyra e punës, mësuesit/instruktorët në shkollë apo agjencitë private të punësimit, përfaqësonin më pak se 1%. I njëjti trend vërehet edhe për të diplomuarit e vitit 2020 në përdorimin e kanaleve të mësipërme.

Për sa i përket gjetjes së punës së parë sipas drejtimeve profesionale që kanë mbaruar të diplomuarit, nuk ka asnjë ndryshim në mënyrën apo kanalet e përdorura. Të diplomuarit në të gjitha llojet e drejtimeve, e kanë gjetur punën e parë nëpërmjet njohjeve dhe kontakteve familjare (81.5%), dhe kanalet më pak të përdorura, vijnë të jenë kanalet formale duke pasur të njëjta përqindje si në tabelën 13.

Tabela 13 Mënyra e gjetjes së punës të parë, 2021

	Rajoni Verior	Rajoni Qendror	Rajoni Jug-lindor	Rajoni Jug-perëndimor	Total
Nëpërmjet Zyrës së Punës	4.9%	0.0%	0.0%	4.4%	0.5%
Nëpërmjet përgjigjes së lajmërimeve të publikuara	3.3%	8.2%	7.6%	3.3%	7.1%
Nga praktika profesionale në biznes	6.6%	4.1%	3.0%	13.2%	4.1%
Nëpërmjet njohjeve, lidhjeve familjare, miqve, të njohurve	80.3%	81.0%	81.8%	84.6%	81.5%
Duke kontaktuar drejtpërdrejt me punëdhënësin tim	3.3%	5.5%	7.6%	7.7%	5.8%
Nga mësuesit në shkollë	1.6%	0.7%	0.0%	0.0%	0.6%
Nëpërmjet një agjencie private të punësimit	0.0%	0.5%	0.0%	0.0%	0.3%


Tabela 14 Mënyra e gjetjes së punës të parë, 2020

	Rajoni Verior	Rajoni Qendror	Rajoni Jug-lindor	Rajoni Jug-perëndimor	Total
Nëpërmjet Zyrës së Punës	0.0%	.9%	1.0%	1.1%	0.8%
Nëpërmjet përgjigjes së lajmërimeve të publikuara	1.8%	4.4%	2.9%	2.2%	3.3%
Nga praktika profesionale në biznes	8.8%	10.1%	5.7%	13.2%	9.6%
Nëpërmjet njohjeve, lidhjeve familjare, miqve, të njohurve	52.6%	65.4%	55.2%	47.3%	58.2%
Duke kontaktuar drejtpërdrejt me punëdhënësin tim	31.6%	16.2%	31.4%	34.1%	24.7%
Nga mësuesit në shkollë	3.5%	1.8%	1.9%	1.1%	1.9%
Nëpërmjet një agjencie private të punësimit	0.0%	0.4%	0.0%	0.0%	0.2%
Tjetër	1.8%	0.9%	1.9%	1.1%	1.2%

Për sa i përket përdorimit të kanaleve të ndryshme të gjetjes së një vendi pune ka dallime midis dy gjinive. Meshkujt janë të prirur më shumë se femrat të gjejnë punë nëpërmjet njohjeve dhe kontakteve familjare. Ndërsa femrat (16.8%), janë më të prirura se meshkujt (5.4%) të gjejnë punë nëpërmjet lajmërimeve të publikuara. Kontakti i drejtëdrejtë me punëdhënësin dhe praktika profesionale, janë kanale pak të përdorura nga të dyja gjinitë, ku përsëri më shumë meshkuj përkundrejt femrave punësohen duke aplikuar me CV ose nga kryerja e praktikës profesionale në një

punëmarrës potencial. Kanalet formale të punësimit si Zyra e Punës ose agjencitë e punësimit, nuk përdoren nga femrat dhe shumë pak nga meshkujt; më pak se 1% e meshkujve ishin të punësuar duke kontaktuar këto të fundit.

Figura 4 Gjetja e punës së parë sipas gjinisë



Integrimi në tregun e punës – karakteristikat kryesore në punën aktuale

Pjesa më e madhe e të diplomuarve që ishin në marrëdhënie pune, punonin në ndërmarrje të vogla, duke reflektuar kështu edhe realitetin/natyrën e bizneseve në Shqipëri. 58.9% punonin në kompani me më pak se 10 punonjës. Kjo dukuri ishte më shumë e theksuar në Rajonin Juglindor (74.2%).

27.8% punonin në kompani të vogla me 10-49 punonjës, 9.2% punonin në kompani të mesme me 50-249 punonjës dhe vetëm 4.1% e të diplomuarve punonin në ndërmarrje të mëdha me më shumë se 250 punonjës. Nuk vërehen ndryshime të theksuara midis rajoneve për sa i përket punësimit në ndërmarrje të mesme; ndërsa, për sa i përket punësimit në ndërmarrje të vogla, kryesisht një e treta e të punësuarve të Rajonit Verior dhe Qendror, punonin në këto kompani. Të diplomuarit në Rajonin Jugperëndimor (5.5%) dhe Qendror (4.8%), kanë tendencën të punësohen në ndërmarrje të mëdha, krahasuar me rajonet e tjera, duke reflektuar kështu përqendrimin e këtyre bizneseve në këto rajone.

Tabela 15 Numri i punonjësve në kompaninë ku të diplomuarit punojnë

	Rajoni Verior	Rajoni Qendror	Rajoni Juglindor	Rajoni Jugperëndimor	Total
Ndërmarrje mikro (1-9 punonjës)	61.7%	54.7%	74.2%	64.8%	58.9%
Ndërmarrje e vogël (10-49 punonjës)	30.0%	31.1%	16.7%	19.8%	27.8%
Ndërmarrje e mesme (50-249 punonjës)	8.3%	9.4%	7.6%	9.9%	9.2%
Ndërmarrje e madhe (>250 punonjës)	0.0%	4.8%	1.5%	5.5%	4.1%

Të pyetur për llojin e kontratës së punës që kishin më punëdhënësin, 55.3% e të diplomuarve deklarorin se kishin kontratë me afat të caktuar me punëdhënësin. Të diplomuarit e Rajonit Jugperëndimor (65.6%) ishin më të prirur të kishin kontratë me afat të caktuar përkundrejt rajoneve të tjera. 25.1 % e të diplomuarve ishin të punësuar pa kontratë, dhe të diplomuarit e Rajonit Juglindor (39.4%) kanë deklaruar se nuk kishin kontratë përkundrejt të diplomuarve në rajonet e tjera. Ndërkohë, 18.4% e të diplomuarve deklarorin se kishin kontratë pa afat, ndërsa vetëm 1.1% e të diplomuarve po bënin praktikë.

Tabela 16 Lloji i kontratës së punës

	Rajoni Verior	Rajoni Qendror	Rajoni Juglindor	Rajoni Jugperëndimor	Total
Kontratë me afat të caktuar	46.7%	56.9%	39.4%	65.6%	55.3%
Kontratë pa afat	31.7%	17.7%	19.7%	12.2%	18.4%
Po bëj praktikë	0.0%	1.5%	1.5%	0.0%	1.1%
Jam pa kontratë	21.7%	24.0%	39.4%	22.2%	25.1%

Të pyetur sa të sigurt apo të stabilizuar ndihen në punën e tyre aktuale, pothuajse gjysma e të diplomuarve në marrëdhënie pune (47%), kishin një perceptim neutral të situatës të tyre aktuale të punësimit. Ky perceptim ishte më i theksuar në Rajonin Jugperëndimor (54.9%). 23.5% e të diplomuarve në marrëdhënie pune, ndihen të sigurt në punën e tyre dhe 12.7%, ndihen shumë të sigurt. Këto perceptime ishin më të theksuara në Rajonin Verior, ku më shumë se gjysma e të diplomuarve (54.1%) ishin të sigurt ose shumë të sigurt në punën e tyre aktuale. Në rajonet e tjera, perceptimi i

sigurisë/stabilitetit të lartë në punën e tyre varionte 32% deri në 39%. Më pak se 10% e të diplomuarve ndihen të pasigurt (9%) ose shumë të pasigurt (7.8%) me situatën e tyre aktuale të punësimit. Ky perceptim ishte më i theksuar në Rajonin Qendror.

Tabela 17 Perceptimi i sigurisë (stabilitet) në punën aktuale

	Rajoni Verior	Rajoni Qendror	Rajoni Juglindor	Rajoni Jug-perëndimor	Total
Shumë i/e pasigurt	0.0%	10.7%	7.7%	0.0%	7.8%
I/E pasigurt	6.6%	9.9%	9.2%	6.6%	9.0%
As i sigurt as i pasigurt/neutral	39.3%	46.7%	44.6%	54.9%	47.0%
I/E sigurt	31.1%	23.0%	18.5%	24.2%	23.5%
Shumë i/e sigurt	23.0%	9.7%	20.0%	14.3%	12.7%


Më shumë meshkuj (18.9%) se femra (5.3%) ndihen të pasigurt ose shumë të pasigurt në punën e tyre aktuale. Ndarja gjinore tregon të njëjtin trend për sa i përket sigurisë/stabilitetit të lartë në punë por në një diferencë më të ulët midis gjinive, ku 37.3% meshkuj përkundrejt 29.8% femrave, ndihen të stabilizuar ose shumë të sigurt në punën e tyre. 64.9% e femrave kishin një perceptim neutral të situatës aktuale të punësimit përkundrejt 43.8% të meshkujve.

Tabela 18 Perceptimi i sigurisë (stabilitet) në punën aktuale sipas gjinisë

	Femër	Mashkull	Total
Shumë i/e pasigurt	3.2%	8.6%	7.8%
I/E pasigurt	2.1%	10.3%	9.0%
As i sigurt as i pasigurt/neutral	64.9%	43.8%	47.0%
I/E sigurt	26.6%	22.9%	23.5%
Shumë i/e sigurt	3.2%	14.4%	12.7%

Ndarja sipas drejtimeve profesionale tregon që të diplomuarit e punësuar që kishin mbaruar drejtime teknike industriale, ishin më të prirur për t'u ndier të sigurt dhe të stabilizuar në vendin e tyre të punës, përkundrejt drejtimeve të tjera. Përkatesisht, 61.5% e të diplomuarve në Elektroteknikë dhe 44.8% në SHMT, ishin të sigurt ose shumë të sigurt në vendin e tyre të punës, përkundrejt 39.7% në TIK, 39.6% në Ekonomi-Biznes dhe 30.4% në Hoteleri-Turizëm. Grafiku paraqet perceptimin e të diplomuarve të punësuar për drejtimitet profesionale me më shumë se 100 të diplomuar të anketuar.

Figura 5 Perceptimi i sigurisë (stabilitet) në punën aktuale sipas drejtimit




Në kuadrin e perspektivës së vetëpunësimit, 59.8% e të diplomuarve e shihnin sipërmarrjen e tyre si një aktivitet të përhershëm. Të diplomuarit në Rajonin Verior (72.7%) dhe Rajonin Qendror (67.3%), ishin më të prirur të shikonin perspektivën e vetëpunësimit si një zgjedhje të përhershme, krahasur me të diplomuarit në dy rajonet e tjera, ku përsëri reflektojnë përqindje të larta. 32.4% e të diplomuarve e shihnin si një aktivitet të përkohshëm, deri në një mundësi punësimi pranë një kompanie. Ky perceptim ishte më i theksuar në Rajonin Juglindor (52.4%) dhe më pak i theksuar në Rajonin Qendror (22.4%).

Tabela 19 Perspektiva e vetëpunësimit

	Rajoni Verior	Rajoni Qendror	Rajoni Jug-lindor	Rajoni Jug-perëndimor	Total
E shoh si një aktivitet të përhershëm timin	72.7%	67.3%	42.9%	52.4%	59.8%
E shoh si një aktivitet të përkohshëm deri në një punësim më të sigurt në një kompani	27.3%	22.4%	52.4%	38.1%	32.4%
Nuk e di	0.0%	2.0%	4.8%	4.8%	2.9%
Tjetër	0.0%	8.2%	0.0%	4.8%	4.9%

Perceptimi mbi perspektivën e vetëpunësimit, është pothuajse i njëjtë midis femrave dhe meshkujve. 60% e meshkujve dhe femrave shprehen se, vetëpunësimin, e shohin si një aktivitet tyrin të përhershëm. 32.4% e të diplomuarve të vetëpunësuar, e shohin aktivitetin e tyre si të përkohshëm deri në një punësim më të sigurt pranë një kompanie, dhe ky perceptim ishte më i theksuar tek meshkujt (33%), krahasuar me femrat (20%).

Figura 6 Perspektiva e vetëpunësimit sipas gjinisë



Integrimi në tregun e punës – të ardhurat

Grafiku më poshtë tregon nivelin e pagave të të diplomuarve të punësuar në të gjitha grupet e analizuar. Raportimi në lidhje me pagat e të diplomuarve përfshin si të diplomuarit e punësuar ashtu edhe ata të vetëpunësuar. 33.6% e të diplomuarve të punësuar kishin të ardhura nga puna në nivelin 40.001-50.000 lekë, ku më i theksuar shfaqet në Rajonin Qendror (34.8%) dhe atë Jugperëndimor (34.2%).

Niveli i pagave, i dyti më i përhapur ishte 32.001-40.000 lekë, ku 31.1% e të diplomuarve të punësuar paguheshin mbi pagën minimale deri në kufirin 40.000 lekë. Vetëm 8.7% e të diplomuarve të punësuar paguheshin nën nivelin e pagës minimale, dhe të diplomuarit nga Rajoni Juglindor rezultojnë të kishin të ardhura nën pagën minimale (rreth 12.8%) përkundrajt të diplomuarve në rajonet e tjera. Ndërkohë, vetëm 3.5% e të diplomuarve të punësuar paguheshin me paga të larta: 2.5% në nivelin e pagave 95.001-120.000 lekë dhe 1.0% mbi pagën 120.000 lekë. Edhe pse përqindjet mbeten në nivele të ulëta për pagat më të larta, rajoni Verior (2.9%) dhe ai Jugperëndimor (2.7%), kanë përqindjet më të larta krahasuar me rajonet e tjera.

Krahasimi i të dhënave të të dyja viteve (grafiku 8), tregon se të diplomuarit e punësuar në vitin 2021 paguheshin me paga më të larta se kohorta e një viti më parë. Vihet re një rënie drastike e të diplomuarve në vitin 2021, që paguheshin me pagë minimale në 8.7%, krahasuar me 30.3% të kohortës së vitit 2020. Gjithashtu, krahasimi i të dhënave, tregon një rritje të konsiderueshme të të diplomuarve, të cilët paguheshin në nivelet e pagave 50.000 – 95.000 lekë nga 12.4% në vitin 2020 në 23.2% në vitin 2021.

Figura 7 Niveli i pagave (neto) sipas rajoneve, 2021





Figura 8 Niveli i pagave (neto), 2020-2021



Grafiku i mëposhtëm paraqet nivelin e pagave sipas gjinisë dhe tregon dallim në paga bazuar tek gjinia, me të punësuarat femra që paguhën më pak se të punësuarit meshkuj. 16.0% e femrave rezultojnë të paguhën me një pagë nën 32.000 lekë, në krahasim me 7.6% të meshkujve. Edhe në kategoritë e tjera të pagave, meshkujt zënë pjesën më të madhe, përveç intervalit 32.001-40.000 lekë, gjë që thekson faktin se më shumë se gjysma e femrave të diplomuara në arsimin profesional dhe të punësuar, mbeten në nivelin pak më lart (40.000 lekë) se paga minimale. Edhe të dhënat për të diplomuarit e vitit 2020 (Figura 10), tregojnë dallim në paga bazuar tek gjinia, por në të njëjtin trend me të dhënat për vitin 2021, ku të punësuarat femra fitojnë më pak se të punësuarit meshkuj.

Figura 9 Niveli i pagave sipas gjinisë, 2021






Figure 10 Niveli i pagave sipas gjinisë, 2020




Ndarja e nivelit të pagave sipas drejtimit profesional të të diplomuarve shfaqet e shpërndarë. Të diplomuarit në drejtimet Hoteleri-Turizëm dhe Elektroteknikë rezultonin të kishin të ardhura në intervalet me paga më të larta. Kështu, 35.1% e të diplomuarve në Hoteleri-Turizëm dhe 34.3% e të diplomuarve në Elektroteknikë siguronin të ardhura më shumë se 50.001 lekë. Krahësuar me të dhënat për vitin 2020, të diplomuarit në drejtimet Mekanikë dhe TIK, ishin më të prirur për të pasur të ardhura në intervalet me paga më të larta. 23.8% e të diplomuarve në Mekanikë dhe 22.1% e të diplomuarve në TIK, siguronin të ardhura më shumë se 50.001 lekë. Të diplomuarit në Ekonomi-Biznes, ishin më të prirur për të siguruar të ardhura deri në nivelin e pagës minimale 32.000 lekë përkundrejt drejtimeve të tjera. I njëjti trend vihet re dhe për të dhënat e vitit 2020, ku të diplomuarit në Ekonomi-Biznes ishin më të prirur për të siguruar të ardhura nën 30.000 lekë përkundrejt fushave të tjera të studimit. Përgjithësisht, për të gjitha drejtimet, niveli i pagës më dominues është nga 40.000-50.001 lekë. Ndërsa për të diplomuarit e vitit 2020 në Hoteleri-Turizëm, Ekonomi-Biznes dhe Mekanikë, niveli më dominues i pagave është niveli i pagës minimale (30.000 lekë), ndërsa për drejtimet e tjera, është 30.001-40.000 lekë.

Figura 11 Niveli i pagave sipas drejtimeve, 2021



Shënim: Në grafik tregohen drejtimet që kanë më shumë se 100 të diplomuar të anketuar që kanë ndjekur atë drejtim.

Figura 12 Figura 10 Niveli i pagave sipas drejtimeve, 2020



Shënim: Në grafik tregohen drejtimet që kanë më shumë se 100 të diplomuar të anketuar që kanë ndjekur atë drejtim.

Integrimi në tregun e punës – përputhshmëria e arsimit

Ky seksion prezanton statistikat e përgjithshme të përputhshmërisë së profileve të studimit në arsimin profesional me vendin e punës. Përqindja e të diplomuarve të punësuar që nuk janë të angazhuar në një punë që lidhet me fushën e tyre të studimit, tregon mosndërlidhje të studimeve me tregun e punës, dhe mospërputhje midis ofertës dhe kërkesës për vendet e punës.

Në total, gjysma e të diplomuarve të punësuar ose 50.5%, punonin në një punë që lidhej me fushën/profilin që kishin studiuar. Ndarja sipas rajoneve, tregon që të diplomuarit e Rajonit Qendror, ishin më të prirur për të punuar në një vend pune që lidhej me studimet e tyre përkundrejt të gjithë rajoneve të tjera, ndërsa të diplomuarit e Rajonit Juglindor, më të prirur për të pranuar një vend pune jashtë profilit të tyre të studimit.

Tabela 20 Përputhshmëria e punës me fushën e studimit

	Rajoni Verior	Rajoni Qendror	Rajoni Juglindor	Rajoni Jug-perëndimor	Total
Po	50.8%	51.4%	43.9%	50.5%	50.5%
Jo	49.2%	48.6%	56.1%	49.5%	49.5%


Për sa i përket pyetjes nëse fusha e aktivitetit lidhet me studimet e kryera, 60.4% e të diplomuarve të vetëpunësuar, u shprehën 'jo'. Kjo dukuri ishte më e theksuar në Rajonin Verior, ku aktiviteti i 90% të të diplomuarve të vetëpunësuar, nuk lidhej me studimet e kryera. Në anën tjetër, për 61.9% të të diplomuarve që kishin një biznes në Rajonin Juglindor, natyra e biznesit lidhej me fushën e studimeve përkundrejt rajoneve të tjera.

Tabela 21 Përputhshmëria e fushës së aktivitetit të vetëpunësimit me studimet

	Rajoni Verior	Rajoni Qendror	Rajoni Juglindor	Rajoni Jug-perëndimor	Total
Po	10.0%	32.7%	61.9%	47.6%	39.6%
Jo	90.0%	67.3%	38.1%	52.4%	60.4%


Ndarja sipas gjinisë tregon se, për 40% të të diplomuarve femra dhe meshkuj që ishin të vetëpunësuar, natyra e aktivitetit lidhej me studimet e kryera.

Figura 13 Përputhshmëria e fushës së aktivitetit të vetëpunësimit me studimet sipas gjinisë (% Po)




Përputhshmëria e punës me profilin e studimeve, shpërfaq dallime gjinore. Të diplomuarit meshkuj ishin më të prirur për të punuar në një vend pune që lidhej me profilin e studimeve të tyre në krahasim me të diplomuarat femra. 52.7% e meshkujve punonin në një punë të përputhshme, në krahasim me vetëm 37.9% të femrave.

Figura 14 Lidhja e punës me studimet sipas gjinisë



Shpërndarja e të dhënave të përputhshmërisë së punës me studimet sipas drejtimeve profesionale, tregon që, të diplomuarit e drejtimeve të caktuara, janë më të prirur për të punuar në një punë që lidhej me studimet e tyre pas mbarimit të shkollës. Përkatësisht, 79.1% e të diplomuarve në Hoteleri-Turizëm dhe 63.2% e të diplomuarve në SHMT, punonin në një fushë të përputhshme me studimet e tyre, përkundrajt rreth një të tretës së të diplomuarve në TIK (35.6%) dhe në Ekonomi-Biznes (31.3%). Ky rezultat, mund të vijë si rrjedhojë e faktit se, pjesa më e madhe e studentëve të këtyre drejtimeve, vazhdojnë studimet e larta, ndaj punësimi i tyre mund jetë me kohë të pjesshme dhe jashtë fushës së studimit.

Figura 15 Lidhja e punës me studimet sipas drejtimit (% Po)



Të dhënat e mësipërme rreth mungesës së përputhshmërisë së studimeve me vendin e punës, konfirmohen edhe në përdorimin e njohurive të fituara gjatë studimeve në vendin e punës. Pjesa dërrmuese e të diplomuarve, treguan se i përdorën shumë/jashtëzakonisht shumë (46.0%) ose aspak/pak (43.7%), njohuritë e marra gjatë studimeve në punën aktuale, dhe vetëm 10.4% treguan përdorim mesatar të njohurive të fituara gjatë shkollës në punën aktuale. Të dhënat për vitin 2020, nuk paraqesin ndryshime thelbësore, por një rritje të vogël të përputhshmërisë së studimeve me tregun e punës, ku vetëm 3.6 pikë përqindje më pak të studentëve, që nuk i kanë përdorur njohuritë e shkollës në vendin e punës, dhe 3.9 pikë përqindje më shumë të studentëve, që kanë një përdorim mesatar të këtyre njohurive.

Më shumë se gjysma e të diplomuarve të punësuar në Rajonin Verior (54.9%) dhe Jugperëndimor (50.9%) nuk janë duke i shfrytëzuar ose janë duke i shfrytëzuar pak aftësitë ose arsimimin e tyre në punën aktuale. Të dhënat paraqesin pothuajse të njëjtën situatë/trend për Rajonin Verior në vitin 2020, ku më shumë të diplomuar të punësuar (60.9%) se në rajonet e tjera, kanë përdorur aspak/pak njohuritë e fituara. Ndërsa, 54.0% e diplomuarve të punësuar në Rajonin Juglindor, i përdornin njohuritë e fituara gjatë studimeve në një shkallë 'shumë' ose 'jashtëzakonisht shumë', i ndjekur nga Rajoni Qendror me 46.5% të të diplomuarve në marrëdhënie pune. Të dy rajonet konfirmojnë edhe situatën e vitit 2020, ku të diplomuarit e Rajonit Qendror (49.6%) dhe atij Juglindor (47.1%), përdorin maksimalisht njohuritë e marra në shkollë gjatë punës së tyre. Të diplomuarit e Rajonit Qendror (12.3%), ishin më të prirur për të shfrytëzuar mesatarisht njohuritë e shkollës krahasuar me rajonet e tjera.

Tabela 22 Shkalla e përdorimit të njohurive të fituara gjatë studimeve në punën aktuale, 2021


	Rajoni Verior	Rajoni Qendror	Rajoni Juglindor	Rajoni Jugperëndimor	Total
Aspak ose pak	54.9%	41.2%	39.0%	50.9%	43.7%
Mesatar	7.0%	12.3%	6.9%	7.1%	10.4%
Shumë ose jashtëzakonisht shumë	38.0%	46.5%	54.0%	41.9%	46.0%

Tabela 23 Shkalla e përdorimit të njohurive të fituara gjatë studimeve në punën aktuale, 2020

	Rajoni Verior	Rajoni Qendror	Rajoni Juglindor	Rajoni Jugperëndimor	Total
Aspak ose pak	60.9%	46.0%	44.5%	44.6%	47.3%
Disi	4.3%	4.4%	8.4%	10.9%	6.5%
Shumë ose jashtëzakonisht shumë	34.8%	49.6%	47.1%	44.6%	46.2%

Në të njëjtën linjë, pothuajse i njëjti numër të diplomuarish konfirmon përputhshmërinë (45.1%) dhe mospërputhshmërinë (45.7%) e pozicionit aktual me studimet. 54.3% e të diplomuarve të Rajonit Juglindor deklarorin se pozicioni i tyre aktual lidhej me studimet e tyre në një shkallë 'shumë' ose 'jashtëzakonisht shumë', në krahasim me 45.8% të Rajonit Qendror, 43.2% të Rajonit Jugperëndimor dhe 32.4% të Rajonit Verior. Më shumë se gjysma e të diplomuarve të Rajonit Verior (55.9%), deklarorin se pozicioni i tyre aktual nuk lidhej aspak ose lidhej pak me studimet përkundrejt të diplomuarve të rajoneve të tjera. Nuk paraqiten ndryshime thelbësore nëse e krahasojmë situatën më të dhënat për të diplomuarit në vitin 2020.

Figura 16 Shkalla e përputhshmërisë së pozicionit aktual me studimet, 2020-2021



Të pyetur nëse shkolla i ka ndihmuar për të gjetur punë, për të katërta rajonet, perceptimi i përgjithshëm është se shkolla nuk i ka ndihmuar. Më shumë se gjysma e të diplomuarve (52.2%) nga të katërta rajonet, u shprehën se, përgjithësisht, shkolla nuk i ka ndihmuar për gjetjen e një pune. 75.6% e të diplomuarve në Rajonin Jugperëndimor shprehën se, përgjithësisht, shkolla nuk i ka ndihmuar për gjetjen e një pune, përkundrejt 62.2% të të diplomuarve në Rajonin Juglindor, dhe më pak se gjysma në Rajonin Verior dhe Qendror. 21.7% e të diplomuarve, u shprehën se, atributi i shkollës qëndronte përgjithësisht tek të të mësuarit e të kërkuarit/aplikuarit për punë; më e theksuar shihet në Rajonin Qendror (25.2%). Ndërsa 15.2% e të diplomuarve, u shprehën se shkolla i ka ndihmuar me orientim drejt mundësive të ndryshme të punësimit; më e theksuar shihet në Rajonin Verior (17.0%) dhe Qendror (16.8%).

Tabela 24 Ndhma nga shkolla për të gjetur punë

	Rajoni Verior	Rajoni Qendror	Rajoni Juglindor	Rajoni Jugperëndimor	Total
Kam mësuar si të kërktoj dhe të aplikoj për punë	19.1%	25.2%	15.3%	12.6%	21.7%
Më ka orientuar mbi mundësitë e ndryshme të punësimit	17.0%	16.8%	13.3%	7.6%	15.2%

	Rajoni Verior	Rajoni Qendror	Rajoni Juglindor	Rajoni Jug-perëndimor	Total
Më ka ndihmuar për të vendosur kontakte me punëdhënës potencialë	10.6%	6.9%	6.1%	3.4%	6.8%
Tjetër	1.1%	0.9%	1.0%	0.8%	0.9%
Përgjithësisht nuk më ka ndihmuar	44.7%	46.6%	62.2%	75.6%	52.2%
Nëpërmjet orientimit për t'u regjistruar te zyra e punës	7.4%	3.5%	2.0%	0.0%	3.3%


4.3 TË DIPLOMUARIT QË PO VAZHDOJNË KUALIFIKIME TË MËTEJSHME

Ky seksion prezanton të dhënat e të diplomuarve që ishin duke vazhduar studime apo trajnime të mëtejshme profesionale.

Institucioni Arsimor në të cilin vazhdojnë studimet të diplomuarit

Nga të diplomuarit e vitit 2021, të cilët vazhdojnë studimet e mëtejshme, 94.6% e tyre vazhdojnë studimet universitare dhe vetëm 5.2% e tyre vazhdojnë formim profesional. Raportin më të lartë të të diplomuarve që vazhdojnë universitetin, e ka rajoni Qendror me 95.8%. Raportin më të lartë, mes rajoneve, të të diplomuarve që vazhdojnë formim profesional, e ka Rajoni Verior me 8.8% të të diplomuarve dhe më të ulët e ka rajoni Qendror me vetëm 3.9% të të diplomuarve.


Figura 17 Të diplomuarit që vazhdojnë studime të mëtejshme sipas institucioneve arsimore dhe rajoneve



Për sa i përket tendencës sipas gjinisë për vazhdimin e studimeve në universitet ose kualifikime profesionale, qartazi, meshkujt (95.8%) kanë një tendencë relativisht

më të lartë për të vazhduar studimet e mëtejshme universitare, krahasuar me femrat (91.2%). Femrat janë më të prirura për zhvillim të vazhduar profesional përkundrejt meshkujve.

Figura 18 Të diplomuarit që vazhdojnë studime të mëtejshme sipas gjinisë



Përgjithësisht, pjesa më e madhe (64.7%) e të diplomuarve që vazhdojnë studimet e mëtejshme, zgjedhin institucionet publike dhe vetëm 35.3% e tyre zgjedhin institucionet private për të vazhduar studimet e mëtejshme. Të diplomuarit në Rajonin Juglindor (86.5%), janë më shumë të prirur të zgjedhin universitetet/institucionet publike, krahasuar me rajonet e tjera. Ndërsa, të diplomuarit e Rajonit Verior, (45.7%) tentojnë të zhvillojnë kualifikime të mëtejshme pranë institucioneve arsimore private. Për sa i përket përzgjedhjes së institucionit arsimor sipas gjinive, më shumë femra se meshkuj ose 68.4%, përkundrejt 63.4% zgjedhin universitete/institucione arsimore publike.

Tabela 25 Institucioni arsimor


	Rajoni Verior	Rajoni Qendror	Rajoni Juglindor	Rajoni Jug-perëndimor	Total
Publik	54.3%	60.5%	86.0%	75.9%	64.7%
Privat	45.7%	39.5%	14.0%	24.1%	35.3%

Lidhja mes fushës së studimeve me studimet e mëparshme

76% të diplomuarve që vazhdojnë studime apo trajnime të mëtejshme, deklarojnë se fusha e studimeve të tyre aktuale, lidhen me studimet e tyre të mëparshme. Të diplomuarit e Rajonit Jugperëndimor (83.3%) janë më të prirur për të vazhduar studime apo trajnime të mëtejshme të lidhura me studimet e mëparshme. Të diplomuarit e Rajonit Juglindor (58.8%) kanë tendencë më të lartë në krahasim me rajonet e tjera, të ndjekin studime/kualifikime të reja, të palidhura me natyrën e studimeve të mëparshme. Ndarja sipas gjinive, nuk shpërfaq dallime të mëdha, ku 77.4% e femrave

përkundrejt 71.7% të meshkujve, qëndrojnë brenda profilit të mëparshëm edhe në studimet e mëtejshme.

Figura 19 Lidhja e fushës së studimeve me studimet e mëparshme sipas rajoneve



Arsyet kryesore të ndjekjes së studimeve/trajnimeve

Të pyetur mbi arsyet më të rëndësishme që i shtynë ata të zgjidhnin studimet e mëtejshme, më shumë se gjysma e të diplomuarve ose 55.7%, ka zgjedhur të vazhdojë studimet e mëtejshme për të arritur një kualifikim më të lartë. Kjo paraqitet si arsyeja kryesore në të gjitha rajonet, por është më shumë e theksuar në Rajonin Jugperëndimor me 64.8% të të diplomuarve.

Ndërkohë që 23.4% e të diplomuarve zgjedhën të vazhdojnë studimet e mëtejshme për të rritur mundësitë e tyre të punësimit, dhe vetëm 19.8% e tyre kanë zgjedhur të ndjekin një tjetër karrierë nga ajo e mëparshme. Të diplomuarit e Rajonit Jugperëndimor (64.8%) dhe Verior (62.9%) janë më të prirur të ndjekin një kualifikim më të lartë; ndërsa, 25.2% e të diplomuarve të Rajonit Qendror, tentojnë të vazhdojnë studime apo trajnime të mëtejshme për të rritur mundësitë në tregun e punës.

Më pak se 1% e të diplomuarve në të katërta rajonet, kanë zgjedhur të ndjekin studime/trajnime të mëtejshme, për shkak se nuk po gjenin dot punë ose për arsye të tjera, dhe kjo arsye është më e theksuar në Rajonin Qendror përkundrejt rajoneve të tjera, të cilët nuk renditnin këtë të fundit si arsye për të ndjekur studime të mëtejshme.

Tabela 26 Arsyet kryesore të ndjekjes së studimeve/trajnimit sipas rajoneve

	Rajoni Verior	Rajoni Qendror	Rajoni Juglindor	Rajoni Jugperëndimor	Total
Për të fituar një kualifikim më të lartë	62.9%	54.1%	51.0%	64.8%	55.7%
Për të rritur mundësitë për të gjetur një punë më të mirë	20.0%	25.2%	21.6%	16.7%	23.4%

	Rajoni Verior	Rajoni Qendror	Rajoni Juglindor	Rajoni Jug-perëndimor	Total
Për të ndjekur një karrierë tjetër profesionale	14.3%	19.3%	27.5%	18.5%	19.8%
Nuk po gjeja dot punë	0.0%	0.7%	0.0%	0.0%	0.4%
Tjetër	2.9%	0.7%	0.0%	0.0%	0.7%

Ndarja sipas gjinive të arsyeve kryesore të ndjekjes së studimeve/trajnimeve, paraqet dallime. 59.2% e meshkujve përkundrejt 45.6% të femrave, synojnë një kualifikim më të lartë; ndërsa femrat krahasuar me meshkujt, synojnë që të ndjekin një karrierë tjetër profesionale, ose të rrisin mundësitë e punësimit në një punë më të mirë nëpërmjet studimeve të mëtejshme.


Tabela 27 Arsyt kryesore të ndjekjes së studimeve/trajnitimit sipas gjinisë

	Femër	Mashkull	Total
Për të fituar një kualifikim më të lartë	45.6%	59.2%	55.7%
Për të rritur mundësitë për të gjetur një punë më të mirë	26.3%	22.4%	23.4%
Për të ndjekur një karrierë tjetër profesionale	26.3%	17.5%	19.8%
Nuk po gjeja dot punë	0.9%	0.3%	0.4%
Tjetër	0.9%	0.6%	0.7%

4.4 TË DIPLOMUARIT PA PUNË

Vetëm 24.8% e të diplomuarve të papunë, rezultojnë duke kërkuar për një punë në katër javët e fundit gjatë periudhës së anketimit. Rajoni me përqindjen më të lartë të të papunëve në kërkim të një pune është ai Qendror me 33.9%, ndërsa rajoni me përqindjen më të ulët, është ai Jugperëndimor me 11.8%. Ndarja gjinore paraqet dallime, ku 31.6% e femrave të papuna, krahasuar me 23.5% të meshkujve janë aktive në kërkimin e një pune së fundmi.

Figura 20 Të diplomuar të papunë (në kërkim të një pune 4 javët e fundit) sipas rajoneve



Të kërkuarit për punë

Të diplomuarit e papunë, që kanë kërkuar për një punë gjatë 4 javëve para momentit të anketimit, pohojnë se mënyra më e shpeshtë që ata kanë përdorur për të kërkuar punë, është nëpërmjet njohjeve familjare dhe miqësore (80.0% pohojnë se kanë zgjedhur këtë mënyrë), si dhe lajmërimeve të publikuara në mediat e ndryshme (68.3%). Kontakti i drejtpërdrejtë me punëdhënësin (5%) dhe Zyrën e Punës (10%), qartazi, nuk janë ndër mënyrat e preferuara për të diplomuarit e papunë në kërkim të një pune. Në tabelën më poshtë shihet dhe shpërndarja e përgjigjeve sipas rajoneve, ku për të katërta rajonet, mënyrat më të përdorura për të kërkuar një punë, janë njohjet familjare dhe miqësore dhe publikimet në kanale të ndryshme informimi. Të gjithë të diplomuarit e papunë në Rajonin Verior dhe atë Jugperëndimor, përdorin këto kanale joformale të të kërkuarit punë. Të diplomuarit e papunë në Rajonin Verior dhe Jugperëndimor, nuk i konsiderojnë aspak Zyrat e Punës ose aplikime të drejtpërdrejta tek punëdhënësit potencialë, si metoda për të kërkuar punë.

Tabela 28 Mënyra e të kërkuarit për punë

Mënyra e të kërkuarit për punë	Rajoni Verior	Rajoni Qendror	Rajoni Juglindor	Rajoni Jugperëndimor	Total
Nëpërmjet Zyrës së Punës	0.0%	10.5%	16.7%	0.0%	10.0%
Nëpërmjet lajmërimeve të publikuara në faqe interneti, media sociale, gazetë etj.	66.7%	65.8%	75.0%	75.0%	68.3%
Nëpërmjet njohjeve, lidhjeve familjare, miqve, të njohurve.	100.0%	81.6%	58.3%	100.0%	80.0%
Duke kontaktuar drejtpërdrejt me punëdhënësin tim (duke dërguar CV etj.)	0.0%	7.9%	0.0%	0.0%	5.0%

Në tabelën 29 tregohet dhe shpërndarja e përgjigjeve sipas gjinisë. Femrat janë më të prirura t'u përgjigjen lajmërimeve të publikuara për punë, ndërsa meshkujt përdorin më shumë kontaktet familjare dhe miqësore për të gjetur punë. Në krahasim me meshkujt, edhe pse në përqindje të ulët, femrat kontaktojnë më shumë Zyrën e Punës për mundësi vakante punësimi.

Tabela 29 Mënyra e të kërkuarit për punë sipas gjinisë

Mënyra e të kërkuarit për punë	Femër	Mashkull	Total
Nëpërmjet Zyrës së Punës	14.3%	3.9%	10.0%
Nëpërmjet lajmërimeve të publikuara në faqe interneti, media sociale, gazetë etj.	42.9%	41.6%	68.3%
Nëpërmjet njohjeve, lidhjeve familjare, miqve, të njohurve.	42.9%	50.6%	80.0%
Duke kontaktuar drejtpërdrejt me punëdhënësin tim (duke dërguar CV etj.)	0.0%	3.9%	5.0%

Ansyeja kryesore që të diplomuarit e papunë nuk kanë kërkuar për një punë gjatë 4 javëve të fundit para pyetësorit, janë planet për t'u larguar nga vendi (47.0% kanë pohuar kështu). Planet për emigrim janë më të theksuara në Rajonin Verior (56.7%) dhe atë Juglindor (47.9%). Mungesa e dëshirës për të punuar (17.1%) renditet e dyta arsye që të diplomuarit e papunë nuk kërkojnë punë. Rreth një e katërta e të diplomuarve të papunë në Rajonin Qendror, Juglindor dhe Jugperëndimor, shfaqin mungesë dëshire për të punuar, krahasuar me vetëm 6.7% të të diplomuarve të papunë në Rajonin Verior. 11% e të diplomuarve të papunë, ishin në pritje të fillimit të punës, me më shumë të diplomuar në Rajonin Jugperëndimor (16.7%), krahasuar me rajonet e tjera. Kujdesi për fëmijët/familjen (më e theksuar në Rajonin Qendror, kushtet shëndetësore, mungesa e besimit, dhe preferenca për të punuar sezonin e ardhshëm (këto të fundit më të theksuara në Rajonin Verior) mbetën ndër arsyet më pak të renditura për të mos kërkuar punë.

Tabela 30 Arsyeja e të moskërkuarit për punë

Arsyeja e të moskërkuarit për punë	Rajoni Verior	Rajoni Qendror	Rajoni Juglindor	Rajoni Jug-perëndimor	Total
Nga sëmundja ose paaftësia	6.7%	0.0%	6.3%	3.3%	3.3%
Kujdesem për fëmijët/familjen	0.0%	9.6%	0.0%	3.3%	4.4%
Po pres të filloj punë së shpejti	13.3%	6.8%	12.5%	16.7%	11.0%
Po pres për sezonin e përshtatshëm	6.7%	5.5%	0.0%	0.0%	3.3%
Nuk kam dëshirë të punoj për momentin	6.7%	19.2%	18.8%	20.0%	17.1%
Nuk kam besim se do të gjej një punë	6.7%	2.7%	0.0%	3.3%	2.8%
Kam në plan të largohem nga vendi	56.7%	43.8%	47.9%	43.3%	47.0%
Tjetër	3.3%	12.3%	14.6%	10.0%	11.0%

Dallimi gjinor është më i dukshëm në tre nga përgjigjet e dhëna. 51.9% e meshkujve të papunë që nuk janë në kërkim të një pune, synojnë emigracionin, kundrejt 19% të femrave të diplomuara të papuna, e cila konfirmon fenomenin social tradicionalisht të dominuar nga meshkujt. 32% e femrave përkundrejt 14.7% të meshkujve, shfaqin mungesë dëshire për të punuar. Ndërsa, 16% e femrave të diplomuara të papuna, krahasuar me 2.6% të meshkujve, ishin të angazhuara në punë të papaguar dhe nuk ishin duke synuar punësimin, gjë që e cila thekson rolin tradicional të grave në kujdesin e fëmijëve ose familjes.

Tabela 31 Arsyeja e të moskërkuarit për punë sipas gjinisë


Arsyeja e të moskërkuarit për punë	Femër	Mashkull	Total
Nga sëmundja ose paaftësia	4.0%	3.2%	3.3%
Kujdesem për fëmijët/familjen	16.0%	2.6%	4.4%

Arsyeja e të moskërkuarit për punë	Femër	Mashkull	Total
Po pres të filloj punë së shpejti	4.0%	12.2%	11.0%
Po pres për sezonin e përshtatshëm	8.0%	2.6%	3.3%
Nuk kam dëshirë të punoj për momentin	32.0%	14.7%	17.1%
Nuk kam besim se do të gjej një punë	4.0%	2.6%	2.8%
Kam në plan të largohem nga vendi	16.0%	51.9%	47.0%
Tjetër	16.0%	10.0%	11.0%

Marrëdhënia me zyrat e punës


Pjesa dërrmuese e të diplomuarve të papunë në kërkim të një pune (88.9%), pohojnë se nuk janë regjistruar në zyrat e punës për të gjetur një punë. Nuk vihen re dallime të theksuara mes rajoneve (Figura 23), por gjithsesi Rajoni Juglindor dhe Qendror, karakterizohen nga më shumë punëkërkues që nuk janë të regjistruar pranë Zyrës së Punës. Për sa i përket ndarjes gjinore, nuk vihen re dallime domethënëse, edhe pse femrat (13.2%) ishin pak më të prirura se meshkujt (10.7%) të regjistroheshin pranë Zyrës së Punës.

Figura 21 Punëkërkues të papunë të regjistruar tek Zyra e Punës



Baza e përgjigjeve: N=243

Figura 22 Punëkërkues të papunë të regjistruar tek Zyra e Punës sipas rajoneve (% Jo)




Të pyetur mbi arsyet se pse nuk janë regjistruar në Zyrën e Punës, pjesa dërrmuese në të katërta rajonet është shprehur se nuk kanë interes të regjistrohen. Në Rajonin Jugperëndimor dhe atë Qendror, shihet më e theksuar mungesa e interesit, me përkatësisht 100.0% dhe 89% të paimentuar. Vetëm 9% e të diplomuarve që kërkojnë punë, kanë shprehur mungesë besimi te ky institucion, ku më e theksuar shihet të jetë tek Rajoni Juglindor (14.5%). Edhe pse në nivele të ulta, përqindje të larta të të diplomuarve të papunë që nuk janë informuar rreth procesit të regjistrimit në zyrat e punës, shihen në rajonin Verior dhe atë Juglindor.

Tabela 32 Arsyeja e mosregjistrimit tek Zyra e Punës sipas rajoneve

Arsyeja e mosregjistrimit tek Zyra e Punës	Rajoni Verior	Rajoni Qendror	Rajoni Juglindor	Rajoni Jugperëndimor	Total
Nuk di si të regjistrohem	3.8%	2.0%	3.6%	0.0%	2.4%
Nuk besoj se do të më ndihmojë	7.7%	9.0%	14.5%	0.0%	9.0%
Nuk kam interes të regjistrohem	88.5%	89.0%	81.8%	100.0%	88.6%


Për sa i përket ndarjes gjinore, më shumë meshkuj (90.6%) se femra (77.4%), shfaqin mungesë interesi për t'u regjistruar tek Zyra e Punës. Ndërsa, për sa i përket besimit tek ndihma e këtij institucioni, femrat (16.1%) me shumë se meshkujt (7.8%), shfaqen skeptikë dhe nuk regjistrohen pranë Zyrës së Punës, ashtu sikurse nuk janë të informuara (6.5%) për procesin e regjistrimit kundrejt meshkujve (1.7%).

Figura 23 Arsyeja e mosregjistrimit tek Zyra e Punës sipas rajoneve



Ndërkohë pjesa më e madhe e të diplomuarve të papunë që janë regjistruar pranë zyrave të punës (55.6%) pohojnë se zyra e punës po i ndihmon në gjetjen e një pune me informacion rreth vendeve të lira të punës, mundësive për trajnim ose me këshilla se si të kërkojnë për punë, kurse pjesa tjetër (44.4%) deklaron se zyra e punës nuk po i ndihmon aspak.

Figura 24 Ndhimja e Zyrës së Punës për të gjetur një punë



Ndarja sipas rajoneve tregon se gjysma e të diplomuarve të regjistruar si punëkërkuar të papunë në Rajonin Jugperëndimor, shprehen se nuk ishin ndihmuar nga Zyra e Punës, ndërsa gjysma tjetër ishte ndihmuar me informacion mbi vendet e lira të punës nga kjo e fundit. Edhe punëkërkuar të papunë të regjistruar, kryesisht ishin ndihmuar me informacion mbi vendet vakante, ndërsa pjesa tjetër (40%) nuk ishin ndihmuar aspak. Në Rajonin Juglindor, 20% janë ndihmuar me informacion mbi mundësi të ndryshme trajnimi, ndërsa pjesa tjetër, përshfaq se: 40% ishin ndihmuar me informacion për vende vakante dhe 40% nuk kishin marrë ndihmë. Në Rajonin Verior, gjysma e të regjistruarve nuk ishin mbështetur/ndihmuar, ndërsa gjysma tjetër ishin ndihmuar me këshilla se si të kërkonin një punë ose me informacion mbi vende të lira pune.

Figura 25 Ndhimja e Zyrës së Punës për të gjetur një punë sipas rajoneve





Figura 26 tregon shpërndarjen sipas gjinisë, ku të gjitha femrat e anketuara shprehen se ishin ndihmuar me informacion për vendet vakante të punës, krahasuar me 31.8% meshkuj. Më shumë se gjysma e meshkujve u shprehën se nuk ishin ndihmuar nga Zyra e Punës për aspekte të punësimit.

Figura 26 Ndhimja e Zyrës së punës për të gjetur një punë sipas gjinisë



Të diplomuarit e papunë në kërkim të një pune, që kanë qenë të punësuar më parë

Nga të diplomuarit e papunë aktualisht, rreth 47.3% pohojnë se kanë qenë të punësuar më parë, ndërkohë që pjesa tjetër nuk ka punuar asnjëherë. Raportin më të lartë të të diplomuarve të papunë që kanë qenë të punësuar më parë, e ka Rajoni Qendror me 54.6% të punësuar më parë, krahasuar me 46.4% të papunësuar më parë; ndërsa për të diplomuarit nga rajonet e tjera, ky raport shfaq më shumë të papunësuar më parë, përkundërt të punësuarve. Ndarja gjinore tregon se 57.9% e femrave të papuna, përkundërt 45.4% të meshkujve të papunë, kanë qenë të paktën një herë të punësuar që nga koha e diplomimit.

Figura 27 Punësuar ose jo që nga koha e diplomimit/mbarimit të shkollës





Figura 28 Punësuar ose jo që nga koha e diplomimit/mbarimit të shkollës sipas rajoneve



Të pyetur se kur ishin larguar nga puna e fundit, siç vërehet në figurën 29, 34.8% të papunë të punësuar më parë janë larguar nga puna 3-6 muaj para momentit që janë pyetur, kurse rreth 1 në 3 (ose 29.6%) është larguar para 1 muaji para këtij momenti. Ndarja gjinore nuk paraqet ndryshime domethënëse, megjithatë, më shumë meshkuj se femra kishin tendencën të largoheshin nga puna deri në 3-6 muaj para momentit të anketimit. Gjithashtu vihet re se më shumë femra (13.6%) se meshkuj (6.5%) i kishin ndërprerë marrëdhëniet e punësimit, për sa i përket intervalit kohor më shumë se 9 muaj.

Figura 29 Largimi nga puna e fundit





Figura 30 Largimi nga puna e fundit sipas gjinisë



Shpërndarja sipas rajoneve nuk tregon dallime domethënëse. Megjithatë, largimi nga puna para 3-6 muajsh momentit të anketimit, ishte më i theksuar tek të diplomuarit e Rajonit Verior (46.2%) krahasuar me rajonet e tjera. 21.4% e të diplomuarve në Rajonin Jugperëndimor, e kishin lënë punën para më shumë se 9 muajve nga momenti që janë pyetur përkundrejt 7.7%, 6.5%, dhe 3.8% të Rajoneve Verior, Qendror dhe Juglindor, përkatësisht. 6.5% e të diplomuarve të Rajonit Qendror, ishin të vetmit që kishin lënë punën në më pak se 1 muaj.

Tabela 33 Largimi nga puna e fundit sipas rajoneve

Koha e largimit nga puna	Rajoni Verior	Rajoni Qendror	Rajoni Juglindor	Rajoni Jug-perëndimor	Total
Para 1 muaji	23.1%	32.3%	30.8%	21.4%	29.6%
Para 1-3 muajsh	23.1%	21.0%	34.6%	21.4%	24.3%
Para 3-6 muajsh	46.2%	33.9%	30.8%	35.7%	34.8%
Më shumë se 9 muaj	7.7%	6.5%	3.8%	21.4%	7.8%
Më pak se 1 muaj	0.0%	6.5%	0.0%	0.0%	3.5%


Dy arsytet mbizotëruese që kanë ndikuar për humbjen e vendit të punës së të diplomuarve që po kërkojnë për punë, janë ato personale (61.9%) dhe arsye të tjera (31.9%), ku më të theksuara mbeten pakënaqësia në vendin e punës (27.8%) dhe emigrimi për arsye pune (16.7%). 76.9% e të diplomuarve në Rajonin Verior, u shprehën se arsytet personale ishin shkak i largimit nga puna, përkundrajt 67.2% të Rajonit Verior, 48% të Rajonit Juglindor dhe 50% të Rajonit Jugperëndimor. Të diplomuarit e Rajonit Verior dhe atij Jugperëndimor, nuk ishin përballur me largim nga puna për shkak të shkurtimeve kolektive, ndërsa për dy rajonet e tjera, ky shkak largimi nga puna, mbetet në përqindje shumë të vogla.

Edhe në këtë rast nuk vihen re dallime domethënëse mes rajoneve.

Table 34 Arsyeja kryesore e largimit nga puna e fundit sipas rajoneve

Arsyet e largimit nga puna e fundit	Rajoni Verior	Rajoni Qendror	Rajoni Juglindor	Rajoni Jug-perëndimor	Total
Më mbaroi kontrata e punës	15.4%	1.6%	4.0%	7.1%	4.4%
Kishte shkurtime në vendin e punës	0.0%	1.6%	4.0%	0.0%	1.8%
Për arsye personale	76.9%	67.2%	48.0%	50.0%	61.9%
Tjetër	7.7%	29.5%	44.0%	42.9%	31.9%

Figura 31 Specifikime të arsyes “Tjetër”



4.5 VLERËSIMI RETROSPEKTIV I TË DIPLOMUARVE PËR SHKOLLËN

Në këtë seksion, paraqiten gjetjet kryesore të vlerësimit retrospektiv të të diplomuarve nga arsimi profesional për institucionin ku kanë ndjekur studimet. 75.4% e të diplomuarve do të zgjidhnin sërish të njëjtën shkollë nëse do të kishin mundësi, dhe ky perceptim nuk shfaq dallime të theksuara bazuar në gjini. Pjesa dërrmuese e të dyja gjinive, ose 81.9% e femrave dhe 74.1% e meshkujve, do të zgjidhnin të njëjtën shkollë. Krahasuar me vitin 2020, më shumë të diplomuar (83.4%) do të zgjidhnin sërish të njëjtën shkollë. Dallime të theksuara midis dy gjinive nuk shfaqen edhe tek të dhënat e vitit 2020. Krahasuar me të diplomuarit e vitit 2021, diferencë e konsiderueshme shihet tek meshkujt, ku 83% e meshkujve të diplomuar në vitin 2020, do të zgjidhnin të njëjtën shkollë krahasuar me 74.1% të meshkujve të diplomuar në vitin 2021.

Figura 32 Zgjedhja e të njëjtës shkollë sipas gjinisë, 2021





Figura 33 Zgjedhja e të njëjtës shkollë sipas gjinisë, 2020



Të pyetur nëse do të zgjidhnin të njëjtin drejtim, në të njëjtën linjë, 74.5% e të diplomuarve do të zgjidhnin të njëjtin drejtim. Figura 34 tregon dallimet gjinore, ku meshkujt më shumë se femrat ishin më të prirur të ndërronin drejtim. 80.7% e të diplomuarve në TIK dhe 80.2% e të diplomuarve në Ekonomi-Biznes, u shprehën se do të rizgjidhnin të njëjtin drejtim, gjë që thekson dy fushat që tradicionalisht kanë qenë zgjedhje primare për shkollim. Në të njëjtën linjë, pjesa dërrmuese e të diplomuarve në Hoteleri-Turizëm, Elektroteknikë, dhe SHMT, do të rizgjidhnin të njëjtën fushë studimi (përkatësisht 77.8%, 77.7% dhe 76.3%).

Figura 34 Zgjedhja e të njëjtës degë/drejtimit sipas gjinisë





Figura 35 Zgjedhja e të njëjtës degë/drejtimit sipas drejtimeve (% Po)



Në pyetësor u përfshinë gjithashtu disa kategori pyetjesh ku të diplomuarit duhej të vlerësonin disa aspekte si infrastruktura, kurrikulat, mësimdhënia, tekstet mësimore, praktika, këshillimi i karrierës, bashkëpunimi i shkollës me zyrën e punës, bizneset etj. Pyetjet u formuluan në mënyrë të tillë që i anketuari të kishte mundësi të zgjidhte përgjigjen nëpërmjet alternativave të parashikuara në pyetësor të cilat ishin të shkallëzuara sipas shkallës Likert.

Aftësitë teorike dhe praktike të stafit mësimdhënës dhe metodat e mësimdhënies vlerësohen shumë dhe jashtëzakonisht shumë nga 93.4% dhe 90.5% e të gjithë të diplomuarve të anketuar respektivisht, ndërsa praktikat në shkollë dhe në biznese nga mbi 87% e të anketuarve. Edhe për sa i përket aspekteve të tjera (si p.sh. infrastruktura, kurrikulat, tekstet mësimore, këshillimi i karrierës), pjesa dërrmuese e të anketuarve i vlerëson shumë dhe jashtëzakonisht shumë. Edhe bashkëpunimi i shkollës me Zyrat e Punës, vlerësohet shumë dhe jashtëzakonisht shumë nga 58.4%. Ndarja sipas rajoneve tregon një shpërndarje të vlerësimeve. Përgjithësisht, të diplomuarit e Rajonit Qendror ishin më të prirur për të vlerësuar shumë dhe jashtëzakonisht shumë aspekte si infrastruktura, kurrikulat, dhe tekstet mësimore, ndërsa të diplomuarit e Rajonit Jugperëndimor ishin më të prirur për të vlerësuar shumë dhe jashtëzakonisht shumë aspekte si praktika në biznes, këshillimi i karrierës dhe bashkëpunimi i shkollës me bizneset apo Zyrën e Punës.

Tabela 35 Fushat që vlerësohen ‘shumë dhe jashtëzakonisht shumë’ sipas rajoneve, 2021

Fushat për përmirësim	Rajoni Verior	Rajoni Qendror	Rajoni Juglindor	Rajoni Jug-perëndimor	Total
Infrastruktura	69.5%	80.7%	75.0%	73.1%	77.6%
Kurrikulat	68.7%	86.7%	74.6%	75.9%	81.5%
Tekstet dhe materialet	74.8%	88.7%	88.6%	82.8%	85.8%
Metodat e mësimdhënies	76.3%	91.9%	93.4%	91.9%	90.5%
Aftësitë teorike dhe praktike të stafit mësimdhënës	82.9%	94.0%	95.1%	96.8%	93.4%
Praktika në shkollë	70.7%	87.7%	92.3%	95.1%	87.8%
Praktika në biznes	75.8%	87.6%	90.8%	94.6%	87.9%
Këshillimi karrierës	64.9%	65.0%	76.2%	85.3%	69.6%
Bashkëpunimi i shkollës me bizneset	63.2%	73.4%	73.4%	86.8%	74.3%
Bashkëpunimi i shkollës me Zyrat e Punës	51.9%	53.1%	62.0%	81.7%	58.4%

Në tabelën 36 paraqiten rezultatet për kategorinë ‘fusha që vlerësohen aspak/pak’. Bashkëpunimi i shkollës me Zyrat e Punës perceptohet nga të diplomuarit si ndër aspektet që vlerësojnë më pak krahasuar me aspektet e tjera - 19% e të diplomuarve mendojnë kështu. Gjithashtu edhe bashkëpunimi i shkollës me biznesin perceptohet nga 9.5% e të diplomuarve si një aspekt jo i vlerësuar. Ndarja sipas rajoneve tregon se përgjithësisht të diplomuarit e Rajonit Verior kanë tendencën për të vlerësuar më negativisht për aspektet e pyetura, krahasuar me rajonet e tjera.

Tabela 36 Fushat që vlerësohen ‘aspak/pak’ sipas rajoneve, 2021

Fushat për ‘pak’ përmirësim	Rajoni Verior	Rajoni Qendror	Rajoni Juglindor	Rajoni Jug-perëndimor	Total
Infrastruktura	2.3%	3.3%	1.7%	1.1%	2.6%
Kurrikulat	3.1%	3.0%	1.7%	1.6%	2.6%
Tekstet dhe materialet	6.1%	4.5%	2.7%	3.2%	4.2%
Metodat e mësimdhënies	9.2%	2.9%	3.3%	1.1%	3.3%
Aftësitë teorike dhe praktike të stafit mësimdhënës	3.9%	1.6%	1.1%	1.1%	1.7%
Praktika në shkollë	15.4%	4.8%	4.4%	2.7%	5.5%
Praktika në biznes	17.7%	6.5%	4.3%	2.7%	6.7%
Këshillimi karrierës	8.4%	5.5%	4.3%	0.5%	4.9%
Bashkëpunimi i shkollës me bizneset	23.3%	8.5%	8.2%	5.3%	9.5%
Bashkëpunimi i shkollës me Zyrat e Punës	32.1%	19.4%	17.9%	9.1%	19%


Dallime gjinore vërehen në të gjitha aspektet që vlerësohen shumë dhe jashtëzakonisht shumë. Sipas të dhënave më poshtë, femrat janë më shumë të prirura të vlerësojnë aspekte më akademike, si kurrikulat, tekstet mësimore, infrastruktura, dhe aspekte të mësimdhënies. Ndërkohë, meshkujt më shumë se femrat vlerësojnë aspekte më praktike dhe që janë të lidhura me punësimin si praktika në biznes, këshillimi i karrierës, dhe bashkëpunimi i shkollës me bizneset apo Zyrat e Punës.

Tabela 37 Fushat që vlerësohen ‘shumë dhe jashtëzakonisht shumë’ përmirësim sipas gjinisë

Fushat për përmirësim	Femër	Mashkull	Total
Infrastruktura	78.60%	77.40%	77.6%
Kurrikulat	86.10%	80.50%	81.5%
Tekstet dhe materialet	91.60%	84.60%	85.8%
Metodat e mësimdhënies	91.2%	90.3%	90.5%
Aftësitë teorike dhe praktike të stafit mësimdhënës	95.8%	92.9%	93.4%
Praktika në shkollë	90.6%	87.2%	87.8%
Praktika në biznes	86.6%	88.2%	87.9%
Këshillimi i karrierës	65.1%	70.5%	69.6%
Bashkëpunimi i shkollës me bizneset	71.6%	74.8%	74.3%
Bashkëpunimi i shkollës me Zyrat e Punës	53.9%	59.4%	58.4%

Të pyetur rreth pritshmërive të tyre për 2 vitet e ardhshme, në 24.8% të rasteve, të diplomuarit dëshironin të kishin filluar një biznes tynin. I njëjti trend shihet dhe tek të diplomuarit e vitit 2020. Vihet re një rënie e konsiderueshme e të diplomuarve që synojnë emigrimin në vitin 2021 me 23.1%, krahasuar me 36.5% të kohortës së vitit 2020. Në 16.6% të rasteve, të diplomuarit e anketuar, planifikonin të gjenin një punë që lidhej me fushën e studimit, krahasuar me 36.8% të të diplomuarve në vitin 2020. Më pak të diplomuar në vitin 2021 (13.2%), synonin të punësoheshin pavarësisht përputhshmërisë së shkollës me punësimin, krahasuar me 17.9% të të diplomuarve në vitin 2020. Vetëm 10.1% dëshironin të vazhdonin studime/kualifikime të tjera brenda 2-vjeçarit të ardhshëm. Krahasuar me kohortën e vitit 2020, nuk vihen re dallime të theksuara, ku 13.8% e të diplomuarve synonin të kualifikoheshin ose të ndiqnin studime të mëtejshme. Ndërsa më pak se 1% planifikonin zhvendosjen në një qytet tjetër brenda vendit.

Figura 36 Pritshmëritë për 2 vitet e ardhshme, 2020-2021 (%)




Ndarja sipas rajoneve tregon dallime të larmishme. Të diplomuarit në Rajonin Qendror dhe Juglindor, janë më të prirur të fillojnë biznesin e tyre në 2-vjeçarin e ardhshëm, krahasuar me rajonet e tjera. Ndërkohë, të diplomuarit në Rajonin Verior dhe Juglindor, synojnë më shumë emigrimin, krahasuar me dy rajonet e tjera. Të anketuarit në Rajonin Verior, synojnë më shumë se të diplomuarit në rajonet e tjera të gjeturit e një pune të përputhshme me fushën e studimit, ndërsa për të diplomuarit e Rajonit Jugperëndimor, e rëndësishme është gjetja e një pune në 2 vitet e ardhshme. Të diplomuarit në Rajonin Juglindor aspirojnë më shumë zhvillimin e studimeve/kualifikimeve të mëtejshme, krahasuar me të diplomuarit në rajonet e tjera.

Tabela 38 Pritshmëritë për 2 vitet e ardhshme (%) sipas rajoneve

	Rajoni Verior	Rajoni Qendror	Rajoni Juglindor	Rajoni Jugperëndimor	Total
Të jem i/e punësuar	13.1%	13.1%	11.2%	16.4%	13.2%
Të kem gjetur një punë që të lidhet me fushën time të studimit/trajnitimit	24.4%	16.7%	14.7%	12.1%	16.6%
Të kem filluar biznesin tim	23.8%	25.7%	25.9%	20.1%	24.8%
Të kem ndjekur studime të mëtejshme	8.1%	10.2%	15.2%	6.1%	10.1%
Të kem emigruar jashtë vendit	26.3%	22.0%	26.3%	22.4%	23.1%
Të kem migruar në një qytet tjetër brenda vendit	0.6%	0.5%	0.0%	0.0%	0.4%
Tjetër	3.8%	11.9%	6.7%	22.9%	11.8%

Ndarja gjinore tregon se meshkujt synojnë të fillojnë një biznes tyrin (26.3%) dhe emigrimin jashtë vendit (24.2%) më shumë se femrat. Ndërkohë femrat më shumë se meshkujt, synojnë të punësohen në një punë që lidhet me studimet e tyre (21.6%) ose në një punë tjetër (15.6%). Femrat dhe meshkujt mendojnë njësoj për sa i përket ndjekjes së mëtejshme të studimeve.

Figura 37 Pritshmëritë për 2 vitet e ardhshme (%) sipas gjinisë





5. KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

Gjurmimi i të diplomuarve shërben si një mjet për të siguruar cilësinë e arsimit profesional dhe lidhjen e aftësive me kërkesat rajonale të tregut të punës. Gjurmimi në nivel kombëtar i të diplomuarve të vitit 2021 në rajonin Verior, Qendror, Juglindor dhe Jugperëndimor, shpërfaqë informacion mbi situatën e punësimit, të dhëna për të diplomuarit e punësuar dhe ata të papunë, të diplomuarit në vazhdim të kualifikimeve të mëtejshme dhe një tablo mbi vlerësimin retrospektiv dhe përvojën e të diplomuarve.

Analiza gjithëpërfshirëse, tregoi se pjesa dërrmuese e të diplomuarve nga shkollat e arsimit profesional në vitin 2021, ishin meshkuj, duke reflektuar kështu edhe situatën e anketimit. Drejtimet më të përfaqësuar ishin Shërbime Mjetesh Transporti, Hoteleri-Turizëm, Teknologji Informacioni dhe Komunikimi, Elektroteknika dhe Ekonomi-Biznes. Shpërndarja sipas rajoneve e të anketuarve, tregon se më shumë se gjysma e të anketuarve (60.5%) i përkasin Rajonit Qendror, ndërsa Rajoni Verior është më pak i përfaqësuar, duke reflektuar në këtë formë, shpërndarjen e numrit të regjistrimeve. Analiza e demografisë, konfirmon edhe të dhënat e përgjithshme mbi situatën e punësimit, ku Rajoni Qendror karakterizohet nga më shumë të punësuar se rajonet e tjera, përkundrejt Rajonit Juglindor, i cili karakterizohet nga më shumë të diplomuar joaktivë ose të diplomuar të papunë, por në kërkim të një pune. Hoteleri-turizëm ishte drejtimi i karakterizuar nga më shumë të diplomuar të punësuar, duke konfirmuar kështu orientimin e formimeve profesionale drejt kërkesave të tregut. Të diplomuarit meshkuj, ishin më të prirur se të diplomuarat femra për të qenë të punësuar.

Analiza e të dhënave të të diplomuarve të punësuar, tregoi se Rajoni Qendror, ka numrin më të lartë (60.8%) të të diplomuarve të punësuar që para diplomimit, ndërsa Rajoni Verior, ka tranzicionin më të ngadaltë drejt tregut të punës, ku më pak të diplomuar fillojnë punën e parë që para diplomimit, krahasuar me rajonet e tjera, dhe duke u krahasuar sërish me rajonet e tjera, më shumë të diplomuar fillojnë punën e parë 9-12 muaj pas diplomimit. Krahasuar me të dhënat për vitin 2020, tranzicioni drejt tregut të punës shihet më i ngadaltë në Rajonin Qendror, ndërsa Rajoni Jugperëndimor (69.9%) ndjekur nga ai Juglindor (69.2%), kanë numrin më të lartë të të punësuarve që para diplomimit/mbarimit të shkollës.

Për sa i përket vetëpunësimit, të diplomuarit e Rajonit Jugperëndimor kanë tendencën të vetëpunësohen në bizneset e familjes, përkundrejt të diplomuarve të Rajonit Juglindor, të cilët ishin më të prirur të fillonin biznesin e tyre para diplomimit. Të vetëpunësuarit në Rajonin Jugperëndimor, janë më shumë të prirur të punësojnë 1-3 persona, përkundrejt të vetëpunësuarve në Rajonin Qendror, të cilët punësonin më shumë se 3 persona në biznesin e tyre. Përdorimi i kanaleve joformale të gjetjes së një pune, ishte i përhapur pothuajse njësoj tek të katërta rajonet, ku mbi 80% e të diplomuarve gjetën punën e tyre të parë nëpërmjet kontakteve familjare, ku më i theksuar vihet re tek Rajoni Jugperëndimor (84.6%). Kanalet joformale për të gjetur një vend pune (si lidhjet dhe njohjet familjare apo shoqërore), mbizotëronin, dhe për të diplomuarit e vitit 2020, ku më të theksuara tregoheshin në Rajonin Qendror (65.4%). Ndarja gjinore tregoi se meshkujt janë të prirur më shumë se femrat të gjejnë punë nëpërmjet njohjeve dhe kontakteve familjare, ndërsa femrat janë më të prirura se meshkujt të gjejnë punë nëpërmjet lajmërimeve të publikuara.

Për sa i përket madhësisë së ndërmarrjes në të cilën ishin të punësuar, të diplomuarit e Rajonit Juglindor kishin tendencën të punonin në mikrondërmarrje, përkundrejt atyre të Rajonit Qendror dhe Juglindor, të cilët ishin të prirur të punonin në ndërmarrje të vogla dhe të mesme ose të mëdha, përkatësisht. Në lidhje me llojin e kontratës së punës që kishin më punëdhënësin, të diplomuarit e Rajonit Jugperëndimor karakterizoheshin të ishin të punësuar me kontrata me afat të caktuar. Kontratat

pa afat ishin karakteristike e të punësuarve të Rajonit Verior, përkundrejt atyre të Rajonit Juglindor, ku pjesa dërrmuese punonin pa një kontratë formale pune.

Perceptimi i përgjithshëm më i përhapur ndër të katërta rajonet mbi sigurinë dhe stabilitetin në punë, ishte neutral. Megjithatë, perceptimet e sigurisë dhe stabilitetit të lartë në punë, ishin më të theksuara tek të diplomuarit e punësuar të Rajonit Verior, përkundrejt atyre të Rajonit Qendror, që u shfaqën më skeptikë për sigurinë në punë. Ndarja gjinore tregoi se më shumë meshkuj se femra, ndihen të pasigurt në punën e tyre aktuale, por njëkohësisht, meshkujt më shumë se femrat, ndihen të stabilizuar në punën e tyre. Për sa i përket sigurisë në punë sipas drejtimit, të diplomuarit e punësuar që kishin mbaruar drejtime teknike industriale, ishin më të prirur për t'u ndier të sigurt dhe të stabilizuar në vendin e tyre të punës, ku të diplomuarit në Elektroteknikë dhe SHMT, ndiheshin të sigurt ose shumë të sigurt në vendin e tyre të punës. Në kuadrin e perspektivës së vetëpunësimit, më shumë se gjysma e të diplomuarve e shihnin sipërmarrjen e tyre si një aktivitet të përhershëm, dhe të diplomuarit në Rajonin Verior dhe Rajonin Qendror ishin më të prirur ta shikonin perspektivën e vetëpunësimit si një zgjedhje të përhershme krahasuar me të diplomuarit në dy rajonet e tjera.

Në lidhje me nivelin e të ardhurave, niveli më i përhapur i pagave për të katërta rajonet, ishte niveli 40.001-50.000 lekë, ku më i theksuar shfaqet në Rajonin Qendror. Rajoni Juglindor karakterizohet nga paga më të ulëta deri në nivelin e pagës minimale dhe ai Verior nga paga mbi 95.000 lekë, krahasuar me rajonet e tjera. Ndarja gjinore tregoi se të punësuarat femra paguhen më pak se të punësuarit meshkujt. Të diplomuarit në drejtimet Hoteleri-Turizëm dhe Elektroteknikë, ishin më të prirur për të pasur të ardhura në intervalet me paga më të larta, Të diplomuarit në Ekonomi-Biznes ishin më të prirur për të siguruar të ardhura deri në nivelin e pagës minimale 32.000 lekë, përkundrejt drejtimeve të tjera. Krahasimi i të dhënave tregon se, të diplomuarit e punësuar në vitin 2021, paguhen me paga më të larta se kohorta e një viti më përpara, ku gjithashtu të punësuarat femra fitojnë më pak se të punësuarit meshkujt edhe në vitin 2020. Krahasimi i të dhënave shpërfaq një rënie drastike e të diplomuarve në vitin 2021 që paguhen me pagë minimale në 8.7%, krahasuar me 30.3% të kohortës së vitit 2020. Gjithashtu, krahasimi i të dhënave, tregon një rritje të konsiderueshme të të diplomuarve, të cilët paguhen në nivelet e pagave 50.000 – 95.000 lekë nga 12.4% në vitin 2020, në 23.2% në vitin 2021.

Për sa i përket përputhshmërisë së fushës së studimit me punën, të diplomuarit e Rajonit Qendror, ishin më të prirur të punësoheshin në një punë që lidhej me fushën e tyre të studimit, dhe të diplomuarit e Rajonit Juglindor, të vetëpunësoheshin në një aktivitet që lidhej me arsimin e tyre. Për më tepër, të diplomuarit e punësuar të Rajonit Juglindor, i përdornin njohuritë e fituara gjatë studimeve në një shkallë 'shumë' ose 'jashtëzakonisht shumë', krahasuar me rajonet e tjera. Rajoni Qendror karakterizohet nga një raport më i lartë i të diplomuarve që vazhdojnë universitetin, ndërsa ai Verior, karakterizohet nga më shumë të diplomuar që vazhdojnë formim profesional krahasuar me rajonet e tjera. Tendenca sipas gjinisë për vazhdimin e studimeve në universitet ishte më e theksuar tek meshkujt, ndërsa femrat ishin më të prirura për zhvillim të vazhduar profesional përkundrejt meshkujve. Pjesa më e madhe (64.7%) e të diplomuarve që vazhdojnë studimet e mëtejshme zgjedhin institucionet publike përkundrejt atyre private. Të diplomuarit e Rajonit Jugperëndimor janë më të prirur për të vazhduar studime apo trajnime të mëtejshme të lidhura me studimet e mëparshme. Arsyeja kryesore që i shtyn të diplomuarit të zgjedhin studime të mëtejshme, është qëllimi i një kualifikimi më të lartë për të katërta rajonet, ku më e theksuar është për Rajonin Jugperëndimor. Meshkujt përkundrejt femrave, synojnë një kualifikim më të lartë, ndërsa femrat synojnë që të ndjekin një karrierë tjetër

profesionale ose të rrisin mundësitë e punësimit në një punë më të mirë nëpërmjet studimeve të mëtejshme.

Të dhënat mbi të diplomuarit të papunë, tregojnë se 24.8% e të diplomuarve të papunë ishin duke kërkuar aktivisht për një punë. Rajoni Qendror ka përqindjen më të lartë të të papunëve në kërkim të një pune, krahasuar me rajonet e tjera. Mënyrat më të përdorura për të kërkuar një punë për të katërta rajonet, janë njohjet familjare dhe miqësore, si dhe publikimet në kanale të ndryshme informimi, ku në krahasim me rajonet e tjera, të gjithë të diplomuarit e papunë (100%) në Rajonin Verior dhe atë Jugperëndimor, përdorin këto kanale informale të të kërkuarit punë. Arsyeja kryesore që të diplomuarit e papunë nuk kanë kërkuar për një punë gjatë 4 javëve të fundit para pyetësorit, ishin planet për t'u larguar nga vendi, dhe kjo ishte më e theksuar në Rajonin Verior dhe atë Juglindor. Ndarje gjinore tregoi se meshkujt synonin emigracionin, kundërsht femrave, e cila konfirmon fenomenin social tradicionalisht të dominuar nga meshkujt. Ndërsa, femrat ishin të angazhuara në punë të papaguar dhe nuk ishin duke synuar punësimin, gjë e cila thekson rolin tradicional të grave në kujdesin e fëmijëve ose familjes.

Analiza mbi vlerësimin retrospektiv konkludoi se pjesa dërrmuese e të diplomuarve, do të zgjidhnin sërish të njëjtën shkollë nëse do të kishin mundësi, dhe ky perceptim nuk shfaq dallime të theksuara bazuar në gjini. I njëjti perceptim vihet re dhe për kohortën e vitit 2020. Aftësitë teorike dhe praktike të stafit mësimdhënës dhe metodat e mësimdhënies, vlerësohen shumë ose jashtëzonisht shumë nga pjesa dërrmuese e të diplomuarve të anketuar. Të diplomuarit e Rajonit Qendror ishin më të prirur për të vlerësuar aspekte si infrastruktura, kurrikulat, dhe tekstet mësimore, ndërsa të diplomuarit e Rajonit Jugperëndimor, aspekte si praktika në biznes, këshillimi i karrierës dhe bashkëpunimi i shkollës me bizneset apo Zyrën e Punës. Bashkëpunimi i shkollës me Zyrat e Punës dhe bashkëpunimi i shkollës me biznesin, perceptohet nga të diplomuarit si ndër aspektet që kanë nevojë për më shumë përmirësim. Pritshmëritë për 2 vitet e ardhshme paraqiten të larmishme për të katërta rajonet. Të diplomuarit në Rajonin Qendror and Juglindor, janë më të prirur të fillojnë biznesin e tyre në 2-vjeçarin e ardhshëm; të diplomuarit në Rajonin Verior dhe Juglindor synojnë më shumë emigrimin; të anketuarit në Rajonin Verior synojnë më shumë të gjeturit e një pune të përputhshme me fushën e studimit, ndërsa për të diplomuarit e Rajonit Jugperëndimor, e rëndësishme është gjetja e një pune në 2 vitet e ardhshme, gjithmonë krahasuar me rajonet e tjera. Të diplomuarit në Rajonin Juglindor, aspirojnë më shumë zhvillimin e studimeve/kualifikimeve të mëtejshme, krahasuar me të diplomuarit në rajonet e tjera.

Bazuar në analizën e përgjithshme të të dhënave nga gjurmimi në nivel kombëtar, janë bërë rekomandimet e mëposhtme:

- Këshillimi mbi mundësitë e punësimit në rajonet (specifikisht në Rajonin Verior) të cilët kanë tranzicion më të ngadaltë drejt tregut të punës.
- Këshillimi mbi mundësitë e vetëpunësimit (hapjes së një biznesi) në Rajonet të cilët janë më pak të prirur për të ndërmarrë start-up-e, këshillim mbi planin e biznesit, dhe mundësitë e ndryshme të financimit (Zyra e Punës nëpërmjet programeve të vetëpunësimit, donatorë dhe organizata potenciale).
- Advokimi i mënyrave formale të gjetjes së një pune, kryesisht forcimi i ndërlikohjes me Zyrat e Punës në funksion të sugjerimit të vendeve vakante dhe programeve kombëtare të punësimit.

- Advokimi dhe forcimi i rolit të shkollave të arsimit profesional në ndihmën e dhënë kundrejt nxënësve, si në këshillim mbi aplikimin e një vendi pune, ndihma për vendosjen e kontakteve të shëndosha me biznesin lokal, por edhe duke shpjeguar dhe përforcuar rolin e Zyrave të Punës në procesin e punësimit.
- Përmirësime të orientuara drejt aspekteve, të cilat kanë pasur më shumë nevojë për përmirësim si praktikat në shkollë dhe në biznese, infrastruktura, kurrikulat, materialet mësimore dhe këshillimi i karrierës.
- Gjurmime në nivel shkolle mbi kuptueshmërinë mbi përputhshmërinë e ofertës për kualifikime, duke kontribuar kështu në zhvillimin e aftësive të kërkuara nga tregu i punës dhe në pajisjen e nxënësve me njohuritë dhe aftësitë e duhura.
- Kryerja e studimeve dhe analizave për parashikimin e aftësive për kualifikime në treg, për të përmirësuar procesin e përputhshmërisë/relevancës.